



FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS
KOSOVA HANDBALL FEDERATION
RUKOMETNI SAVEZ KOSOVA

EDICIONI 2025/26

PROPOZICIONET E GARAVE

Federata e Hendbollit e Kosovës
10000 Pristina, Republic of Kosovo
Tel: +383 38 248 758
Mob: +383 44 508 996
Email: kg@kosovahandball.info
Ëeb: ëëë.kosovahandball.info

Përmbajtja

I. Parathënie	2
II. Dispozitat e përgjithshme	2
III. Shpërblimet	4
IV. Orari i garave	4
V. Pjesëmarrja në gara dhe sistemi i garave	5
VI. Organizimi i garave	11
VII. Palestra Sportive	17
VIII. Organizmi i ndeshjes	18
IX. Obligimet në gara	22
X. Lojtarët në gara	25
XI. Veshjet e sportive	26
XII. Trajnerët në gara	27
XIII. Zyrtarët e FHK-së	28
XIV. Dënimet e klubeve	33
XV. Dënimet e lojtarëve, personave zyrtar, trajnerëve, gjyqtarëve dhe vëzhguesve-kontrolluesve	35
XVI. Organizmi i reklamave në palestër	39
XVII. Afatet ligjore	39
XVIII. Përmbyllja	41

I. Parathënie

- 1.1. Në bazë të nenit 6 pika alineja e 5-të e Statutit të FHK, në mbledhjen e vet të mbajtur më 06.07.2024 me propozim të Komisarit të garave hedh ne diskutim propozicionet e garave për edicionin 2025/26
- 1.2. Propozicionet e garave për Superligën e meshkujve, Superligës së femrave, të Ligës së Parë për meshkuj dhe femra për vitin garues 2025/26, ne raste të ndryshme ligat mund të kenë edhe emërtime të ndryshme të partnerëve, të gjitha klubet dhe personat zyrtar janë të përdoren në të gjitha publikimet zyrtar, njoftimet për shtyp, konferenca për shtyp, programet, reklamat, etj që kanë të bëjnë me garën.
- 1.3. Logo zyrtare e Superligave janë të disponuar dhe udhëzuesin e përdorimit të tyre në web faqen e FHK-së
- 1.4. Me këto propozicione përcaktohet mënyra dhe kushtet e zhvillimit të garave në Superligë për meshkuj dhe femra, Ligën e parë për meshkuj dhe femra për vitin garues 2025/26. Kurse për grupmoshat e reja (Junior, kadet-e, dhe pionier-e) do të aprovohen me Propozicionet e veçanta për grupmosha të reja.
- 1.5. Për ndarjen e skuadrave në grupe, mënyrën e organizimit të ndeshjeve dhe gjithë çka ka të bëjë me garat do të përcaktohet në Propozicionet e garave për grupmoshat e reja që do të aprovon Bordi i FHK-së, në rastet dhe kushtet tjera kur në janë të parapara me këto propozicione zbatohen aktet tjera normative si Rregullorja Disiplinore, Rregulloret e EHF dhe IHF.

II. Dispozitat e përgjithshme

- 2.1. Garat i udhëheq Komisari i garave të cilin e zgjedh Bordi i FHK-së çdo vit garues, i cili për punën e tij i përgjigjet Bordit. Selia e KG-së është në Prishtinë në lokalet e FHK-së Shtëpinë e Sporteve.
Tel: +381 38 248 758,
Mob:+383 44 508 996,
E-maili: kg@kosovahandball.info
Webfaqja: www.kosovahandball.info ,
- 2.1.1. Komisari i garave ka këto të drejta dhe obligime:
 - Drejtpërdrejt udhëheq me garat e të gjitha kategorive, dhe niveleve duke u bazuar në aktet normative në fuqi të FHK-së,
 - Regjistron ndeshjet,
 - Shpall Listën e personave zyrtarë (gjyqtarëve, vëzhgues- kontrolluesve) të aprovuar nga Këshilli Drejtues i SHGJHK-së, dhe i vërtetuar nga Bordi i FHK-së
 - Cakton gjyqtarët për ndeshjet e Kampionatit dhe të Kupës së Republikës së Kosovës (sipas propozimit të Komisionit (Komisarit) për delegim, kurse në rastet kur bënë ndonjë ndryshim nga propozimi i SHGJHK-së të njëjtin e informon me shkrim për arsyet e ndryshimit
 - Cakton vëzhguesit dhe kontrolluesit për ndeshjet e Kampionatit dhe të Kupës së Republikës së Kosovës
 - Vendos mbi të gjitha çështjet lidhur me organizimin e garave në shkallë të parë.
 - Vendos në shkallë të parë për të gjitha dënimet e shqiptuara kohore dhe në të holla të parapara me aktet normative.
 - Udhëheq procedurën disiplinore dhe vendos në shkallë të parë duke iu shqiptuar dënime klubeve, lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve, kontrolluesve, vëzhguesve dhe personave të tjerë zyrtarë.

- Nxjerr Buletin zyrarë pas çdo xhiroje apo seance dhe atë iu dërgon me post elektronike:
- Të gjitha klubeve pjesëmarrëse në gara,
- Kryetarit dhe sekretarit të FHK-së, si dhe anëtarëve të Bordit,
- SHGJHK-së dhe SHTHK-së.
- Pranon ankesat në vendimet e Komisarit të garave, dhe komplet materialin duke dhënë arsyetimin e vendimeve të shqiptuara dhe duke konstatuar pagesën e taksës së paraparë për ankesë të njëjtën ja përcjellë në shqyrtim të mëtejme organit të shkallës së dytë – Këshillit të garave.
- Bashkëpunon me të gjitha Komisionet dhe Këshillat e FHK-së,
- Bënë të gjitha përgatitjet për sezonin e ardhshëm
- Ushtron dhe kryen edhe punë të tjera me qëllim të mbarëvajtjes së suksesshme të Garave.

2.2. Garat për Superligën e meshkuj dhe femra, Ligën e parë për meshkuj dhe femra, si dhe në Ligat e grup-moshave e të rinjve, zhvillohen sipas:

- Rregullave të lojës së IHF,
- Udhëzimin e FHK-së për përdorimin e teknologjisë
- EHF reklamimi mbi rregullat e veshjes
- Ligji për parandalimin e dhunës në sport dhe rregullat mbi sigurinë e garave sportive
- Kodin e sjelljeve të FHK-së dhe IHF
- Rregullat e arbitrazhit
- Rregulloren e FHK-së për ANTIDOPING dhe Kodi Anti Doping të WADA
- Manuali i zbatimit të licencimit të trajnerëve të SHTHK-së
- Manuali i vendosjes së parketit,
- Manuali i vendosjes së reklamave elektronike
- Manuali i prodhimit të transmetimit të FHK-së
- Udhëzimet për transmetim drejtpërdrejt dhe konferencat për shtyp
- Udhëzimi për fotografi dhe
- akteve normative të Federatës së Hendbollit të Kosovës.

2.3. Parimet e lojës së ndershme do të respektohen nga klubet antare të FHK-së në të gjitha ndeshjet. Këtu përfshihet jo vetëm trajtimi i klubit mysafir, gjyqtarëve dhe delegatëve, por edhe sjellja e spektatorëve ndaj të gjitha palëve pjesëmarrëse:

- Respektoni rregullat e lojës dhe rregulloret që rregullojnë garën
- Respektoni të gjithë pjesëmarrësit (lojtarët, zyrtarët, spektatorët, përfaqësuesit e mediave, Ndeshjet e Kupës Evropiane të EHF do të luhen në përputhje me rregullat aktuale të lojës të IHF-së. Ndryshimet në nivel teknik janë të mundshme. etj).
- Nxitja e shpirtit sportiv dhe ndjekja e misionit kulturor.
Vendimet ligjore të organeve të EHF-së ose organeve të njohura nga EHF-ja mbizotërojnë në rastet e kundërshtimit me pikat individuale të këtyre rregulloreve.
Merrni pjesë në mënyrë korrekte dhe sportive, duke mos ndikuar në ndonjë garë dhe/ose zyrtarë në mënyrë të padrejtë ose duke u përpjekur të manipuloni ndonjë rezultat.

2.4. Komisari i garave përpilon Buletin dhe atë ua dërgon klubeve dhe personave zyrtarë, si dhe të interesuarve përmes shërbimit të FHK-së (zyrës së FHK-së) me anë të postës elektronike. Buletini e zëvendëson aktin e shkruar (vendimin dhe të gjitha vendimet disiplinore të vendosura në shkallën e parë (Komisioni i garave), mirëpo në të duhet të theksohen elementet e dispozitave të Rregullores, akteve normative në të cilat është bazuar organi në rastin konkret, si dhe të jepet udhëzim juridik mbi dënimet e shqiptuara.

III. Shpërblimet

- 3.1. Skuadra fituese Kampion i Kosovës për edicionin 2025/26 nderohet me medalje të arta dhe Kupën e FHK-së, kurse skuadra e plasuar ne vendin e dytë me medalje të argjendi.
 - 3.1.1. Tri (3) skuadrat e para të klasifikimit përfundimtarë, fitojnë të drejtën për pjesëmarrje në garat e Kupave të EHF-it dhe gjithashtu fituesi i Kupës së Kosovës duke u bazuar në Rregulloret e EHF-së
 - Kampionia e Kosovës tek femrat ka të drejtë të paraqitjes në European League.
 - Kurse skuadrat e plasura në vendin e dytë dhe tretë kanë të drejt pjesëmarrje në European Cup
 - Ne rastet kur skuadrat kampione është edhe fituese e Kupës, automatikisht skuadra finaliste e Kupës së Kosovës fiton të drejtën e paraqitjes në garat EHF European Cup.
 - 3.1.2. Federata e Hendbollit ka te drejtë të kufizoj të drejtën e pjesëmarrjes ne garat e Kupës për skuadrat te cilat nuk i plotësojnë kushtet elementare (kuadër jo te mjaftueshëm te lojtarëve, qëndrueshmëri financiare). Skuadrat mund te paraqiten por FHK nuk merr përgjegjësi për pjesëmarrjen ne garat e EHF.
 - 3.1.3. Skuadra Kampione në Superligën e meshkujve për edicionin 2025/26 nga FHK-ja shpërblehet me shumë monetare prej **7500€**.
 - 3.1.4. Skuadra Kampione në Superligën e femrave për edicionin 2025/26 nga FHK-ja shpërblehet me shumë monetare prej **5000€**.
- 3.2. Skuadra e cila shpallet kampion dhe fituesi i Kupës në konkurrencën e meshkujve dhe në konkurrencën e femrave duhet të zhvillojnë ndeshjen e Superkupës. Ne rast se fituesi i titullit dhe i Kupës është e njëjta skuadër, atëherë në ndeshje te Superkupës do të luaj me skuadrën finaliste e Kupës së Kosovës. Në rast se ndeshja përfundon me rezultat të barabartë, aplikohen propozicionet e Kupës së Kosovës.
Superkupa e Kosovës zhvillohet një javë para fillimit të edicionit në Superligë.
- 3.3. Çka nuk është paraparë në këto Propozicione vlejnë dhe do të zbatohen dispozitat e Akteve normative të FHK-së dhe Rregullat e EHF-it dhe IHF-it.

IV. Orari i garave

- 4.1. Orarin për fillimin e garave dhe kalendarin e garave duhet të jetë përputhje me kalendarin e zhvillimit të garave ndërkombëtare, të cilin e përpilon Komisari i garave dhe i njëjti miratohet nga bordi i FHK-së.

11.08.2025	Regjistrimi i Klubeve në Superligën e meshkujve dhe femrave
12.08.2025	Tërheqja e shortit për ediconin 2025 -26 Superliga e meshkujve dhe femrave
25.08.2025	Regjistrimi i klubeve në Ligën e parë meshkujt dhe femrat
02.09.2025	Tërheqja e shortit për Ligën e parë meshkujt dhe femrat
20/21.09.2025	Fillimi i Superligës së meshkujve dhe femrave, Ligës së kadetëve dhe kadeteve
28/29.09.2025	Fillimi i ediconit 2025/26 në Ligën e parë meshkujt dhe femrat

V. Pjesëmarrja në gara dhe sistemi i garave

Regjistrimi për Superligën e meshkujve dhe femrave, Ligën e parë meshkujt dhe Ligën e kadetëve është i vlefshëm vetëm nëse të gjitha dokumentet e kërkuara, etj. janë në dispozicion në FHK në kohën e duhur brenda afatit të përcaktuar.

- 5.1. Skuadrat e Superligës së Kosovës në të dy konkurrencat janë të obliguara që deri me 11.08.2025 të bëjnë paraqitjen e skuadrave sipas Rregullores mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, statusi dhe transferimi i tyre. Mosparaqitja e klubit brenda afatit të përcaktuar do të sanksionohet sipas **14.1.**
- 5.2. Skuadrat pjesëmarrëse në Superligën e meshkujve dhe femrave janë përcaktuar sipas rankimit nga edicioni paraprak.
- 5.3. Skuadrat pavarësisht përcaktimit janë të obliguar që para fillimi të çdo edicioni të bëjnë regjistrimin e tyre përmes formularëve zyrtar të dërguar nga Komisari i garave, duke u mbështetur në nenin 5.1. të Statutit të FHK-së

Në regjistrim i tillë konsiderohet i kompletuar nga klubi:

- Kurë ka të dorëzuar të gjitha dokumentet e regjistrimit të cilat nënshkruhen nga personi/përfaqësuesi që ka të drejtë ligjore të paraqes klubin (deklaratat në lidhje me nënshkrimi zyrtar të të drejtave të bashkëngjitet sipas kërkesës)
- Dorëzimin e certifikatës së regjistrimit të klubit, dhe personin e autorizuar
- Formularin 3.1 me listën e lojtarëve të licencuar për edicionin përkatës
- Listën e personave zyrtar të licencuar dhe të specifikuar në pozita, formulari 3.2
- Formularin për regjistrimin e lojtarëve në sistemin elektronik të FHK-së
- Formularin 3 për regjistrimin e klubit në nivelin përkatës të garave
- Deklaratën nën betim

- 5.4. Për më tepër, FHK ka të drejtë të mos pranojë klube në garat e rregullta, të cilat nuk plotësojnë kërkesat përkatëse teknike dhe/ose organizative dhe/ose financiare dhe/ose administrative.
 - 5.4.1. Klubi në rast të paraqitjes në gara dhe tërheqjes së tij pas pranimi të regjistrimit të klubit, dhe pas tërheqjes së shortit do të sanksionohet me **500€-1000€** dhe **1-3 vite** mospjesëmarrje në gara.
 - 5.4.2. Në rastet kur klubi tërheqet nga garat për ndonjë arsye madhore, mungesa e infrastrukturës apo ndonjë gjëje tjetër do të sanksionohet me **500€-1000€**.
- 5.5. Kampionati i Kosovës për edicionin 2025/26 fillon me 20/21.09.2025 . dhe përfundon me 3/4 .06.2025.

5.5.1. Pjesëmarrës në Superligën e Kosovës në konkurrencën e meshkujve për vitin garues 2025/26 janë këto skuadra:

	Skuadra	Qyteti
1	KH Rahoveci	Rahovec
2	KH Kastrioti	Ferizaj
3	KH Besa Famgas	Pejë
4	KH Trepça	Mitrovicë
5	KH Prishtina	Prishtinë
6	KH Vushtrria	Vushtrri
7	KH Llapi	Podujevë
8	KH Vëllaznimi	Gjakovë

5.5.2. Pjesëmarrës në Superligën e Kosovës në konkurrencën e femrave për vitin garues 2025/26 janë këto skuadra:

	Skuadra	Qyteti
1	KHF Istogu	Istog
2	KHF Samadrexha	Vushtrri
3	KHF Ferizaj	Ferizaj
4	KHF Shqiponja	Gjakovë
5	KHF Kastrioti	Ferizaj
6	KHF Vushtrria	Vushtrri
7	KHF Besa	Pejë
8	KHF Tereza	Obiliq
9	KHF Prishtina	Prishtinë
10	KHF Ulpiana	Lipjan

5.5.3. Pjesëmarrës në Ligën e parë të Kosovës në konkurrencën e meshkujve për vitin garues 2025/26 janë këto skuadra:

	Skuadra	Qyteti
1	KH Deçani	Deçan
2	KH Drita	Gjilan
3	KH Prizreni	Prizreni
4	KH Istogu	Istog
5	KH Ulpiana	Lipjan
6	KH Drenica	Drenas
7	KH KEK-u	Obiliq
8	KH Vjosa	Shtime
9	KH Lepenci ?	Kaçanik
10	KH Dukagjini	Klinë
11	KH Samadrexha ?	Vushtrri
12	KH Zhegra ?	Gjilan

5.5.4. Pjesëmarrës në Ligën e parë të Kosovës për femra për vitin garues 2025/26
janë këto skuadra:

	Skuadra	Qyteti
1	KHF Dukagjini	Klinë
2	KHF Vjosa	Shtimje
3	KHF KEK-u	Obiliq
4	KHF Prizreni	Prizreni
5	KHF Trepça	Mitrovicë
6	KHF Llapusha	Malishevë
7	KHF CLICK	Prizren
8	KHF Jusuf Gërvalla	Deçan
9	KHF Drita ?	Gjilan
10	KHF Vëllaznimi ?	Gjakovë
11	AS Dinamo ?	Rahovec
12	KHF Fushë Kosova ?	Fushë Kosovë

- 5.6. Skuadrat e Superligës së meshkujve dhe femrave janë të obliguara që në gara ti paraqesin edhe skuadrat e të gjitha grup-moshave të reja si të obliguara. Kurse Liga e parë e femrave dhe meshkujve ato duhet ti kenë grupmoshat e Pionierëve dhe Fatosëve.
- 5.7. Ekipet në Procesverbal të ndeshjes mund të paraqesin nga 16 lojtarë-re dhe 5 zyrtarë. Lojtare nga bota e jashtme që nuk janë shtetase të Kosovës në procesverbal dhe të drejt loje kanë vetëm 6 lojtare.
- 5.7.1. Skuadrat e kadeteve dhe kadetëve si dhe pionierëve dhe pioniereve janë të obliguar që në formacion në procesverbalin e ndeshjes dhe në fushë ti kenë minimum 12 lojtare respektivisht lojtarë.
- 5.7.2. Skuadra e cila nuk i përmbahet nenit 5.7.1 do të dënohet si vijon:
- Skuadra e kadetëve dhe kadetëve të ri (pionierët) gjobiten me 50 €
 - Skuadra e kadeteve dhe kadeteve të reja (pionieret) gjobiten me 50 €

5.7.3. GRUP- MOSHAT E REJA - MESHKUJT

	Kategoria	Viti i lindjes	Kohë zgjatja e lojës
1	Juniorët	2006 dhe më të rinj	2 x 30 min.
2	Kadetët	2008 dhe më të rinj	2 x 25 min.
3	Pionierët	2010 dhe më të rinj	2 x 20 min.
4	Fatosët	2012 dhe më të rinj	2 x 15 min.
5	U12	2014 dhe më të rinj	2 x 12 min.

5.7.4. GRUP- MOSHAT E REJA - FEMRAT

	Kategoria	Viti i lindjes	Kohë zgjatja e lojës
1	Kadetet	2008 dhe më të rinj	2 x 25 min.
2	Pionieret	2010 dhe më të rinj	2 x 20 min.
3	Fatoset	2012 dhe më të rinj	2 x 15 min.
4	U12	2014 dhe më të rinj	2 x 12 min.

- 5.8. Gara e grupmoshës U12 djemtë dhe vajzat** zhvillohet gjatë Javës së EHF-së ku do të zhvillohen ndeshje në formë të turneut 2-ditorë në një qytet të caktuar ku do të jetë Festival i Hendbollit për fëmijët e shkollave dhe grupmoshës U12.
Të drejtë pjesëmarrje do të kenë edhe shkollat e programit “Sporti në Shkolla” dhe poashtu klubet e regjistruara në FHK.
Pas çdo grumbullimi do të ndahen Kupa dhe medalje për fituesit e turneut.
Grumbullimet do të jenë çdoherë në qytete të ndryshme nga herat e kaluara.
Të drejtë loje kanë lojtarët të lindur 2014 e më të rinj.
Loja zgjatë 2x12min, lejohet vetëm mbrojtja individuale dhe mbrojtja 3:3 por asesi mbrojtje fllaster. Madhësia e topit 0.
- 5.9. Gara e grup-moshës së fatosëve dhe fatoseve** zhvillohet me sistem grumbullimi në pjesën pranverë, dhe skuadrat e Superligës dhe Ligës së parë në të dy konkurrencat janë të obliguara që të paraqesin skuadrat e kësaj grup-moshe për gara të cilat zhvillohen të ndara në grupe në të kundërtën skuadra e parë (seniorët) do të dënohet me marrjen e 2 (dy) pikëve dhe 500 euro, dhe në edicionin e garave 2026/27 starton me – 2 pikë.
- 5.9.1.** Skuadrat e grup-moshës së **fatosët dhe fatoset** zhvillojnë ndeshjet sipas sistemit të dyfishtë të garave vetëm në pranverë.
- 5.9.2.** Garat i zhvillojnë në muajin maj 2026, dy skuadrat e renditura në vendet e parë dhe të dytë në grupin A, B, C dhe D do të jenë pjesë e garave shtesë prej 8 skuadrat e cekura do të jenë pjesë e garave shtesë që zhvillohen sipas sistemit të Kupës, pra ndeshjet çerekfinale, ndeshjet gjysmëfinale dhe ndeshjet finale, në rastet kur kemi të bëjmë me tri grupe do të kualifikohen dy skuadrat e renditura në vendin e parë në grupin A, B dhe C nga tri grupet dy skuadrat më të mira për nga rezultatet që plasohen në vendet e treta në grupet A, B dhe C do të kualifikohen në garat shtesë. Kurse në rastet kur kemi të bëjmë me dy grupet 4 skuadrat e renditura nga 2 grupet do të kualifikohen në ndeshjet çerekfinale të cilat do të zhvillojnë garë 1 grupit me të 4 e grupit tjetër, i 2 i grupit me të 3 e kështu me radhë.
- 5.9.3.** Ndeshjet në garat e fatosave zgjasin 30 minuta (2x15 min), gjatë zhvillimit të ndeshjes klubet ju lejohet të luajn mbrojtje 3:3, 3:2:1, 5:1 dhe 4:2. Është e ndaluar të luhet 6:0, 5+1, 4+2 dhe mbrojtje fllaster. Madhësia e topit 1. Mos respektimi i këtij paragrafi vëzhguesi - kontrolluesi i ndeshjes është i obliguar që të paraqes në formularin nr.19 (Fletëparaqitje).
- 5.9.4.** Mos respektimi i paragrafit dy (2) do të sanksionohet me 50 euro gjobë, ndërsa në rast të mos paraqitjes nga personat zyrtar (vëzhguesi – kontrolluesi dhe gjyqtarët) do të sanksionohen me 50 euro gjobë.
- 5.9.5.** Skuadra e cila renditet e para në fund të edicionit shpallet Kampion i Kosovës për edicionin e garave 2025/26. Skuadra fituese nderohet me Kupën e FHK-së, kurse 3 skuadrat e para edhe me medalje.
- 5.10. Gara e grup-moshës së pionierëve (m)** zhvillohet para ndeshjes së seniorëve në Superligën e meshkujve në pjesën pranverore kurse në Ligën e parë të meshkujve në pjesën vjeshtore dhe pranverore të edicionit 2025/26. Skuadrat e Superligës dhe Ligës së parë në të dy konkurrencat janë të obliguara që të paraqesin skuadrat e kësaj grup-moshe për gara, në të kundërtën skuadra e parë (seniorët) do të dënohet me marrjen e 2 (dy) pikëve dhe 500 euro, dhe në edicionin e garave 2026/27 starton me – 2 pikë.

- 5.10.1. 6 skuadra të Superligave do të jenë pjesë e garave shtesë ndërsa 2 do të jenë nga Ligat e para. 8 skuadrat e cekura do të jenë pjesë e garave shtesë që zhvillohen sipas sistemit të Kupës, pra ndeshjet çerekfinale, ndeshjet gjysmëfinale dhe ndeshjet finale.
- 5.10.2. **Gara e grup-moshës së pioniereve (f)** zhvillohen gjatë sezonit vjeshtor dhe pranveror të ndara në **2 grupe** sipas kalendarit të garave. Skuadrat e Superligës dhe Ligës së parë janë të obliguara ti paraqesin ekipet në të kundërtën skuadrës seniore do të mirren 2 (dy) pikë dhe 500 euro gjobë dhe në edicionin 2026/27 starton me -2 pikë.
4 skuadrat e para të grupeve do të jenë pjesë e garave shtesë që zhvillohen sipas sistemit të Kupës, pra ndeshjet çerekfinale, gjysmëfinale dhe finale.
- 5.10.3. Lojtarët të cilat luajnë në Ligën e pioniereve (f) kanë të drejtë loje po në të njëjtën ditë edhe për skuadrën e Ligës së kadeteve.
- 5.10.4. Mos pjesëmarrja në ndeshjet e play off-it në Ligen e pionierëve dhe pioniereve do të sanksionohet me 500 € gjobë.
- 5.10.5. Ndeshja në garat e pionierëve zgjatë 40 minuta (2 x 20 min) ndërsa ndeshja finale zgjatë 60 minuta (2x30 min). Gjatë zhvillimit të ndeshjes skuadrave ju ndalohe sistemi i lojës, 6:0, 5+1 dhe 4+2, njëkohesisht nuk lejohet lojtarin sulmues të ruhet (fllaster) në mënyrë që mos vi deri të posedimi i topit, ose të ndiqet nga do që lëviz në fushën e lojës. Kurse skuadrave ju lejohet, të zhvillojnë ndeshjen në këtë sistem, 3 : 3, 3 : 2 : 1, 5 : 1 dhe 4 : 2. Madhësia e topit 2. Mos respektimi i këtij paragrafi vëzhguesi-kontrolluesi i ndeshjes, është i obliguar që të paraqes në formularin nr.19 (Fletëparaqitje).
- 5.10.6. Mos respektimi i paragrafit dy (2) do të sanksionohet me 50 euro gjobë, ndërsa mos paraqitja nga personat zyrtar (vëzhguesi – kontrolluesi dhe gjyqtarët) do të sanksionohet me 50 euro gjobë.
- 5.10.7. Skuadra e cila renditet e para në fund të edicionit shpallet Kampion i Kosovës për edicionin e garave 2025/26. Skuadra fituese nderohet me Kupën e FHK-së, kurse 3 skuadrat e para edhe me medalje.
- 5.11. Skuadrat e grup-moshës së kadetëve dhe kadeteve** zhvillojnë ndeshjet sipas sistemit vajtje – ardhje gjatë stinorit vjeshtorë.
- 5.11.1. Liga e kadetëve i zhvillon garat në pjesën e parë të kampionatit për ndeshje të skuadrave të seniorëve me sistem të garave vajtje-ardhje gjatë edicionit vjeshtor. 4 skuadrat e renditura të parat pas 14 javëve do të zhvillojnë fazën e FINAL4 ku skuadra fituese do të shpallet Kampion i Kosovës për edicionin 2025/26.
- 5.11.2. Gjithashtu Liga e kadeteve i zhvillon në para ndeshje të skuadrave të seniorëve me sistem të garave vajtje-ardhje, gjatë edicionit vjeshtor dhe pranveror. 4 skuadrat e renditura të parat pas 18 javëve do të zhvillojnë fazën e FINAL4 ku skuadra fituese do të shpallet Kampion i Kosovës për edicionin 2025/26.
- 5.11.3. Skuadra e cila renditet e para pas FINAL4 në fund të edicionit shpallet Kampion i Kosovës për edicionin e garave 2025/26 nderohet me Kupën e FHK-së dhe medalje ndërsa vendi i dytë dhe i tretë me medalje.
- 5.12.** Skuadrat e Superligës së meshkujve janë të obliguara që të kenë edhe skuadrat e juniorëve, kurse skuadrat e Ligës së parë nuk e kanë të obliguar por mund të paraqesin skuadrat për gara në Ligën e juniorëve.
Liga e juniorëve zhvillohet gjatë fazës së dytë të Kampionatit dhe është e ndarë nga ligat seniore dhe që fillon në muajin mars 2026, dhe do të ndahet në dy grupe. Pas përfundimit të ndeshjeve me sistem vajtje – ardhje zhvillohet Final 4. Në të marrin 2 skuadra nga grupi A dhe 2 nga grupi B. Skuadra e plasuar në vendin parë në grupin A takohet me skuadrën e plasuar në vendin e 2 në grupin B, kurse skuadra e plasuar në vendin e parë në grupin B takohet me skuadrën e plasuar në vendin e dytë në grupin A, fituesit takohen në finale.

- 5.12.1. Lojtari juniorë ka të drejtë të paraqitet në lojë për skuadrën e seniorëve, por jo në të njëjtën ditë kur luan edhe për skuadrën e juniorëve, paraqitja e tij nënkupton regjistrimin e ndeshjes me rezultat zyrtar 0:10 për kundërshtarin.
- 5.12.2. Skuadra e cila renditet e para në fund të edicionit shpallet **Kampion i Kosovës për edicionin e garave 2025/26**. Skuadra fituese nderohet me Kupën e FHK-së, kurse 3 skuadrat e para edhe me medalje.
- 5.13. Skuadrat e Ligës së parë në konkurrencën e meshkujve** garat i zhvillojnë sipas rotacionit me sistem të dyfishtë të pikëve, vajtje - ardhje gjatë sezonit vjeshtor dhe pranveror 2025/26.
- Pjesa e parë e garave në edicionin vjeshtorë 2025/26.
 - Pjesa e dytë e garave në edicionin pranveror 2025/26.
- 5.13.1. Skuadra që mbledhë më së shumti pikë pas përfundimit të dy stinorëve (vjeshtë –pranverë) Shpallet **Kampion i Ligës së parë për edicionin garues 2025/26** dhe fiton statusin e anëtarit të Superligës së meshkujve për edicionin garues 2026/27.
- 5.13.2. Skuadra e cila renditet në vendin e 2 (dytë) pas përfundimit të garave në Ligën e parë të Kosovës për meshkuj fiton të drejtën të zhvillon ndeshjen suplementare me skuadrën e renditur në vendin e 7-të në Superligën e meshkujve në terren neutral, dhe fituesi i ndeshjes automatikisht bëhet anëtar i Superligës për edicionin garues 2026/27.
- 5.14. Skuadrat e Ligës së parë në konkurrencën e femrave** garat i zhvillojnë sipas rotacionit me sistem të dyfishtë të pikëve, vajtje - ardhje gjatë sezonit vjeshtor dhe pranveror 2025/26.
- Pjesa e parë e garave në edicionin vjeshtorë 2025/26.
 - Pjesa e dytë e garave në edicionin pranveror 2025/26.
- 5.14.1. Skuadra që mbledhë më së shumti pikë pas përfundimit të dy stinorëve (vjeshtë –pranverë) Shpallet **Kampion i Ligës së parë për edicionin garues 2025/26** dhe automatikisht e fiton statusin e anëtarit të Superligës së femrave për edicionin garues 2026/27.
- 5.14.2. Skuadra e cila renditet në vendin e 2 (dytë) pas përfundimit të garave në Ligën e parë të Kosovës për femra fiton të drejtën të zhvillon ndeshjen suplementare me skuadrën e renditur në vendin e 9-të në Superligën e femrave në terren neutral, dhe fituesi i ndeshjes automatikisht bëhet anëtar i Superligës për edicionin garues 2026/27.
- 5.15. Superliga në konkurrencën e meshkujve** numëron 8. skuadra dhe garat i zhvillojnë me sistem të katërfishtë vajtje – ardhje.
- 5.15.1. Pjesa e rregullt prej 28 javëve ku takohen secili me secilin në sistemin vajtje – ardhje nga dy herë.
- 5.15.2. Pjesa e dytë e kampionatit zhvillohet sistemi i PLAY-OFF-it dhe Play-Out, me ç'rast në gjysmëfinale (katër) skuadrat e para takohen sipas renditjeve 1-4 dhe 2-3, fituesit që fitojnë dy ndeshje, respektivisht 4 pikë kualifikohen për finale.
- 5.15.3. Fitues të ndeshjeve finale të Superligës së Kosovës në konkurrencën e meshkujve do të jetë ajo skuadër e cila e para do të fitojë gjashtë (6) pikë apo i fiton tre ndeshje nga pesë të mundshmet. Në ndeshjen e parë, të tretën dhe eventualisht të pestën, vendas do të jenë skuadrat me plasman më të mirë gjatë garave gjatë sezonin të rregullt prej 28 javësh.

5.16. Superliga në konkurrencën e femrave numëron 10 skuadra dhe garat i zhvillojnë në dy pjesë:

- Pjesa e parë e garave – kampionale (18 javë)
- Pjesa e dytë - garat shtesë (Play- Off dhe Play-Out)
- Pjesa e dytë e Kampionatit të Superligës në të dy konkurrencat, garat shtesë (Play- Off) zhvillohen pas përfundimit të garave të pjesës së parë (të rregullt) dhe në të marrin pjesë skuadrat e renditura prej vendit 1-rë deri në vendin 4-të.
- Në gjysmëfinale të garave shtesë (Play-off-it) në Superligën e femrave do të takohen skuadrat që gjenden në pozitat 1-rë dhe 4-të , dhe skuadrat që gjenden në pozita 2 dhe 3 të renditjes tabelore të garave të rregullta të pjesës së parë të Kampionatit.
- Në të gjitha ndeshjet dhe rastet kur përcaktohet renditja apo përparësia e terrenit vendas, përparësi kanë skuadrat e plasuar më lartë në renditjen tabelore gjatë garave të pjesës së rregullt të Kampionatit.

Fitues të ndeshjeve gjysmëfinale të Superligës së Kosovës në konkurrencën e femrave do të jenë ato skuadra të cilat të parat do të fitojnë katër (4) pikë apo i fitojnë të dy ndeshjet. Në ndeshjen e parë dhe eventualisht të tretën, vendës do të jenë skuadrat me plasman më të mirë gjatë garave në pjesën e parë.

5.16.1. Fitues të ndeshjeve finale të Superligës së Kosovës në konkurrencën e femrave do të jetë ajo skuadër e cila e para do të fitojë gjashtë (6) pikë apo i fiton tre ndeshje nga pesë të mundshmet. Në ndeshjen e parë, të tretën dhe eventualisht të pestën, vendas do të jenë skuadrat me plasman më të mirë gjatë garave në pjesën e parë.

5.17. Ndeshjet e Kampionatit dhe ato për Kupën e Kosovës, zhvillohen sipas Rregullave Ndërkombëtare të lojës, Rregulloreve dhe dispozitave të FHK-së, EHF-it dhe IHF –it.

Pikët pas ndeshjes së përfunduar fitohen në këtë mënyrë:

Për fitore2 pikë
Për barazim1 pikë
Për humbje0 pikë

5.18. Të gjitha ndeshjet do të luhen në përputhje me rregullat aktuale të lojës të IHF -së Ndryshimet në nivel teknik janë të mundshme.

Të gjitha ndeshjet do të luhen 2 x 30 minuta me një pushim të pjesës së parë prej 10 minuta kurse në ndeshjet finale të Playoff-it në Superligën e meshkujve dhe femrave, pushimi i pjesës së parë do të jetë 15 minuta, kurse në raste të garave të grupmohave të reja përcaktohet me nenin 5.7.3 dhe 5.7.4.

VI. Organizimi i garave

6.1. Organizimi i garave në Superligën e meshkujve, Superligën e femrave, Ligën e parë meshkujt, Ligën e parë femrat dhe Ligat e grupmohave të reja (juniorë, kadetëve/e, pionierëve/e, fatosë/fatose dhe U12) bëhet sipas sistemit të garave të përcaktuar në dispozitë V të këtyre Propozicioneve.

6.2. Skuadrat të Superligës së Kosovës në konkurrencë e meshkujve që i kanë humbur ndeshjet gjysmëfinale nuk do të zhvillojnë ndeshjet për vend të tretë dhe të katërt, por plasmani i tyre do të përcaktohet në bazë të renditjes tabelore gjatë Kampionatit të rregullt para garave shtesë.

6.2.1. Në garat shtesë (Play-off) të Superligës së meshkujve në qoftë se ndonjë ndeshje përfundon në kohë të rregullt me rezultat baras, ndeshjet duhet të luhet 2 x 5 minuta dhe deri në fund duhet të ketë fitues i cili i merr automatikisht 2 pikë.

- 6.2.2. Skuadra fituese në gjysmëfinale është skuadra e cila fiton dy ndeshje, ose skuadra e cila e para i grumbullon 4 pikë. Ndërsa në ndeshjet finale fituese do të jetë skuadra e cila grumbullon 6 pikë.
- 6.2.3. **Çdo ndeshje e Play-offit** që përfundon baraz, atëherë ndeshja do të vazhdohet 2 x 5 minuta.
- 6.2.4. Nëse edhe me këtë rast rezultati është baraz, do të vazhdohet prapë 2x5 minuta. Nëse edhe në këtë rast rezultati është baraz, fituesi do të përcaktohet me ekzekutimin e nga 5 shtatësheve nga lojtarët e ndryshëm (portën, ku do të ekzekutohen shtatëshe e caktojnë gjyqtarët ndërsa me short do të përcaktohet skuadra, e cila e para do të ekzekutojë shtatëshe). Nëse edhe atëherë kemi rezultatin e barabartë loja vazhdon me ekzekutimin e nga 1 shtatëshe (shënohen prapë 5 emra që mund të jenë të njëjtit lojtarë nga raundi i parë, por që fituesi mund të përcaktohet në ekzekutimin e shtatësheve të para). Rradha e ekzekutimit i kalon skuadrës e cila në short ishte e dyta për ekzekutim.
- 6.2.5. Nëse edhe pas ekzekutimit të shtatësheve rezultati mbetet baraz atëherë zbatohet mënyra e njëjtë përsëri. Shënohen 5 emra dhe fituesi mund të përcaktohet në ekzekutimet e para.
- 6.3. Skuadra që renditet në vendin e 8-të të Superligës së meshkujve (pas garave të rregullta prej 28 gjyrove) humbin statusin e anëtarit të Superligës dhe nga edicioni garues 2026/27, do të bëjë gara një rang më të ulët të garave.
- 6.4. Skuadra që renditet në vendin e 7 -të të Superliga e meshkujve (pas 28 gjyrove) do të zhvillon një ndeshje suplementare (Play-out) në terren neutral me skuadrën e renditur në vendin e dytë (2) të Ligës së parë të meshkujve, fituesi do e fiton statusin e anëtarit të Superligës së meshkujve për edicionin garues 2026/27.
- 6.4.1. Kurse në fillim të edicionit 2026-27, Superliga e Meshkujve do t'i numëroj 8 të skuadra. Që i bie që në fund të edicionit 2025-26, do të humbin statusin e Superligës së Meshkujve skuadrat e renditura në vendin e 8- të, kurse skuadra që renditet në vendin e 7-të do të zhvilloj ndeshjen suplementare me skuadrën e renditur në vendin e 2-të në Ligën e Parë Meshkuj.
- 6.5. Skuadra që renditet vendi i 10-të të Superligës së femrave humb statusin e anëtarit të Superligës dhe nga edicioni garues 2026/27 do të bëjë gara një rang më të ulët të garave.
- 6.6. Skuadra që renditet në vendin e 9 -të Superligës së femrave do të zhvillon një ndeshje suplementare (Play-out) në terren neutral me ekipin e renditur në vendin e dytë (2) të Ligës së parë të femrave, fituesi do e fiton statusin e anëtarit të Superligës së femrave për edicionin garues 2026/27.
- 6.6.1. Kurse në fillim të edicionit 2026/27, Superliga e femrave do të numëron 10 skuadra që i bie që në fund të edicioni 2025/26 do të humbin statusin e Superligës së femrave skuadrat e renditura nga vendi i 10-të . kurse skuadra e renditur në vendin e 9 - të do të zhvillon ndeshje suplementare me skuadrën e renditur në vendin e 2-të në Ligën e parë femrat.
- 6.7. Nëse gjatë zhvillimit të ndeshjeve të garave shitesë ndërpritet ndeshja për shkak të sulmit fizik ndaj personave zyrtar apo skuadrës kundërshtarë, apo ndonjë parregullsi tjetër dhe ndeshja regjistrohet me rezultat zyrtar, ekipi i ndëshkuar automatikisht shkualifikohet nga garat e mëtejshme dhe në edicionin 2026/27 starton me -5 pikë minus.
- 6.8. Skuadrat në garat, Ligës së parë për femra dhe meshkuj renditen në tabelën e klasifikimit në bazë të pikëve të fituara. Në qoftë se dy apo më shumë ekiye kanë numrin e njëjtë të pikëve, atëherë renditja në tabelën e klasifikimit përcaktohet në njërin nga këto mënyra:

- 6.9.** Në bazë të pikëve të fituara në duele në mes të dy ose më shumë ekipeve.
- 6.9.1. Skuadra më e mirë është ajo që ka fituar më shumë pikë në këto duele.
- 6.9.2. Nëse kanë numër të njëjtë të pikëve, atëherë skuadra më e suksesshme është ai që ka gol-dallim më të mirë në ndeshjet e drejtpërdrejta e cila përcaktohet në fund te edicionit përkatës.
- 6.9.3. Nëse në ndeshjet e drejtpërdrejta edhe gol-dallimi është i njëjtë, atëherë skuadra më i suksesshëm është ai i cili ka shënuar më shumë gola si mysafir në ndeshjet e drejtpërdrejta
- 6.9.4. Nëse edhe në këtë rast nuk mund të përcaktohet renditja, skuadra më e suksesshme është skuadra e cila ka gol dallimin e përgjithshëm më të mirë.
- 6.9.5. Nga paragrafi 6.9.1 dhe 6.9.4, përcaktohet në fund të edicionit përkatës ku behet renditja përfundimtare e klasifikimit.
- 6.9.6. Nëse edhe në këtë mënyrë (ndeshjet e drejtpërdrejta) nuk mund të caktohet renditja në tabelën e klasifikimit, atëherë do të caktohet një ndeshje në terren neutral.
- 6.9.7. Nëse ndeshja përfundon baraz, atëherë ndeshja do të vazhdohet 2 x 5 minuta.
- 6.9.8. Nëse edhe me këtë rast rezultati është baraz, do të vazhdohet prapë 2x5 minuta. Nëse edhe në këtë rast rezultati është baraz, fituesi do të përcaktohet me ekzekutimin e nga 5 shtatësheve nga lojtarët e ndryshëm (portën, ku do të ekzekutohen shtatëshet e caktojnë gjyqtarët ndërsa me short do të përcaktohet skuadra, e cila e para do të ekzekutojë shtatëshet). Nëse edhe atëherë kemi rezultatin e barabartë loja vazhdon me ekzekutimin e nga 1 shtatëshe (shënohen prapë 5 emra që mund të jenë të njëjtit lojtarë nga raundi i parë, por që fituesi mund të përcaktohet në ekzekutimin e shtatësheve të para). Rradha e ekzekutimit i kalon skuadrës e cila në short ishte e dyta për ekzekutim.
- Nëse edhe pas ekzekutimit të shtatësheve rezultati mbetet baraz atëherë zbatohet mënyra e njëjtë përsëri. Shënohen 5 emra dhe fituesi mund të përcaktohet në ekzekutimet e para.
- 6.9.9. Portierët mund të seleksionohen nga lista dhe të zëvendësohen në përputhshmëri me Rregullat e lojës. Portierët mund të ekzekutojnë gjuajtje dhe gjuajtësit mund të luajnë si portierë.
- 6.9.10. Gjyqtarët zgjedhin portën në të cilën do të ekzekutohen gjuajtjet. Zgjedhja e ekipit për të ekzekutuar gjuajtjen e parë bëhet në bazë të shortit. Ekipi që fiton shortin mund të zgjedh nëse dëshiron të ekzekutojë i pari apo i fundit.
- 6.9.11. Nëse shënimet janë të barabarta pas rrethit të parë, ekzekutimi i 7 m duhet të vazhdojë përdërisa nuk të arrihet vendimi (fitorja e njërit skuadër).
- 6.9.12. Rrethin e dytë duhet ta fillojë ekipi kundërshtarë. Përsëri duhet të caktohen pesë lojtarë që kanë të drejtë të luajnë (lojtarët e emëruar më parë mund të emërohen përsëri). Në rrethin e dytë arrihet vendimi me ndryshimin në diferencën e golave pasi që të dyja skuadrat kanë ekzekutuar nga një gjuajtje. Pas 5 gjuajtjeve përsëri duhet të emërohen 5 lojtarë të cilët kanë të drejtë të luajnë (lojtarët e emëruar më parë mund të emërohen përsëri)
- 6.9.13. Lojtarët dhe portierët me të drejtë loje janë lojtarët që në raportin e ndeshjes nuk janë të pezulluar, shkualifikuar apo përjashtuar.
- 6.9.14. Shkeljet serioze gjatë ekzekutimit të 7 m do të sanksionohen me shkualifikim. Nëse ekzekutuesi është shkualifikuar apo lënduar duhet të zëvendësohet me një lojtarë shtesë.
- 6.9.15. Derisa bëhet ekzekutimi i gjuajtjeve, vetëm ekzekutuesi, portieri aktual dhe gjyqtari mund të gjenden në gjysmën përkatëse të fushës.
- 6.9.16. Nëse numri i lojtarëve me të drejtë loje është më pak se 5, atëherë një lojtarë mund të emërohet për të ekzekutuar gjuajtjen për herë të dytë në të njëjtën rreth.
- Nëse edhe pas ekzekutimit të 7 m të dy rrethëve rezultati mbetet baraz ekzekutohen nga një shtatëshe deri në fitore definitive (këto shtatëshe mund t'i ekzekutojë i njëjti lojtar).
- 6.10.** Nëse janë më shumë se dy ekipe, renditja e tabelës do të caktohet në bazë të:
- 6.10.1. Tabelës në miniaturë të formuar nga rezultatet e këtyre klubeve të luajtura mes vete. Shpenzimet e garave si dhe organizimin e ndeshjes në terren neutral i cakton Komisari i garave. Ndërsa shpenzimet i bartin skuadrat në mënyrë të barabartë sipas llogarisë së bërë nga Komisari i

garave.

6.11. Ndeshja regjistrohet nga KG-ja me rezultat zyrtar 10:0 në bazë të procesverbalit dhe deklaratave të personave zyrtarë në këto raste:

- 6.11.1. Nëse skuadra nuk ka udhëtuar pa arsye;
- 6.11.2. Nëse fusha nuk është përgatitur me fajin e vendësit (mikpritësit);
- 6.11.3. Nëse skuadra është paraqitur me lojtarë që nuk janë të regjistruar në mënyrë të rregullt, licencuar, janë të dënuar ose pezulluar (suspenduar);
- 6.11.4. Nëse skuadra paraqitet me lojtarë të cilëve u ka kaluar kontrollimi mjekësor apo nuk ka fare kontroll mjekësor;
- 6.11.5. Nëse vendësi nuk e ka siguruar mjekun e licencuar apo dëshminë valide në ndeshje;
- 6.11.6. Nëse nuk e dokumenton se ka bërë kërkesë për sigurimin e ndeshjeve në Policinë e Kosovës.

6.12. Përveç që ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar 10:0 skuadrës do t'i merret edhe një pikë në këto raste:

- 6.12.1. Nëse skuadra e dorëzon ndeshjen ose ndeshja nuk zhvillohet me fajin e tij.
- 6.12.2. Nëse skuadra e lëshon fushën ose nuk mundëson vazhdimin e lojës së filluar.
- 6.12.3. Nëse skuadra kundërshtar nuk pranon të zhvillojë ndeshjen për shkaqe të paarsyeshme
- 6.12.4. Nëse me fajin e skuadrës ndërpritet ndeshja.
- 6.12.5. Nëse ndeshja ndërpritet, për shkak të sulmit fizikë ndaj personave zyrtar apo skuadra kundërshtar.
- 6.12.6. Në rastër kur skuadra nuk udhëton për të ta zhvilluar ndeshje sipas paragrafit 6.11.1, 6.11.2, 6.12.1, 6.12.3, 6.12.5. do të dënohet:
 - 200 € gjobë për klubin e Superligës së meshkujve
 - 150 € gjobë për klubin e Superligës së femrave
 - 100 € gjobë për klubin e Ligës së parë të meshkujve dhe femrave
 - 50 € gjobë për klubin e grupmoshave të reja.

6.13. Ndeshja mund të ndërpritet përkohësisht edhe përfundimisht.

6.13.1. Ndeshja mund të ndërpritet përkohësisht:

- për shkak të acarit apo nxehtësisë së madhe, përkatësisht kur fusha fiton ato karakteristika ku pamundësohet kontrolli ndaj topit,
- për shkak të territ apo ndriçimit të dobët i cili është në kundërshtime me ato të paraparat në Propozicionet e garave dhe aktet tjera normative të FHK-së,
- për shkak të sjelljes së pahijshme dhe huligane të shikuesve, përkundër vërejtjeve të tërhequra nga personat e autorizuar (gjyqtarë, përfaqësuesit zyrtarë të klubit vendas),
- për shkak të konfliktit dhe qerimit të hesapeve në mes lojtarëve, trajnerëve dhe personave zyrtarë të ekipeve,
- për shkak të trazirave në fushë, pengimit të lojës nga shikuesit apo për organizim të dobët.

Në rastet kur loja ndërpritet përkohësisht, për shkak të fuqisë madhore, ndërprerja zgjat aq sa zgjat ajo situatë.

Ndeshja e re do të fillojë, përkatësisht do të vazhdojë prej momentit të ndërprerjes.

Ndeshja e ndërprerë përkohësisht duhet të zhvillohet brenda 24 orëve, duke filluar nga momenti i ndërprerjes.

6.13.2. Ndërprerja deri në fund e ndeshjes:

- për shkak të sulmit në personat zyrtar (gjyqtarë, vëzhgues-kontrollues) lojtarë, trajner,
- për shkak të ofendimeve (sharjeve të ndryshme) të lojtarëve kundërshtarë, anëtarëve të Bordit të FHK-së, personave zyrtarë etj. Gjyqtarët dhe vëzhgues-kontrolluesi duhet ta ndërprejnë ndeshjen, të ju tërhiqet vërejtja e fundit skuadrës organizatore, nëse përsëritet automatikisht të zbrazin palestrën dhe ndeshja të vazhdon pa shikues,
- kur janë cenuar rregullat e lojës deri në atë masë, ku gjyqtarët përkundër masave të ndërmarra nuk mund ta përfundojnë ndeshjen,

Para vendimit për ndërprerjen e ndeshjes deri në fund vëzhgues – kontrolluesi dhe gjyqtarët janë të obliguar të kërkojnë nga ekipi vendas:

- të evitojnë mangësi rreth organizimit të ndeshjes nëse ndërprerja është pasojë e organizimit të dobët,
- ti vënë rregullat në fushë,
- ti zbrazë tribunat apo pjesërisht ti largoi shikuesit nga njëra anë e palestrës,

Nëse edhe atëherë nuk është kthyer rendi në fushë, atëherë gjyqtarët e ndërpresin takimin deri në fund.

Tek ndeshjet e ndërprera përfundimisht nuk ka vazhdim të lojës.

6.14. Ndeshjet e të gjitha ligave mund të zhvillohen ditën të shtunave prej orës 11:00 deri në ora 20:00, dhe të dielave deri në ora 18:00 (në rastet kur nuk pengon zhvillimin e grupeve në garat e pionierëve dhe pioniereve). Ndërsa gjatë ditëve të javës e hënë e premte ndeshjet mund të zhvillohen jo më herët se ora 16:00 dhe jo më vonë se ora 20:00.

6.14.1. Komisari i garave mund të shtyjë terminin e zhvillimit të ndeshjeve të Kampionatit e me kërkesë të njërit skuadër, kërkesë kjo që paraqitet më së paku 72 orë më herët.

Kërkesës i bashkëngjitet arsyeja me shkrim, për çka vendos Komisari i garave.

Skuadra që nuk ka termin të përhershëm për kohën e zhvillimit të ndeshjes, është i obliguar që së paku 72 orë para zhvillimit të ndeshjeve të radhës për atë javë, të informojë Komisararin e garave (zyrën e FHK-së). Në rastet kur skuadra vendas vonon terminin e ndeshjes do të sanksionohet me 50 euro gjobë.

6.14.2. Nëse ndeshja transmetohet drejtpërdrejt nga TV, atëherë termini i saj duhet të përputhet me atë të TV-së (ndeshjet e ditës së diel mund të zhvillohen edhe pas orës 18:00).

6.14.3. Po ashtu përjashtim bëjnë edhe ekipet të cilat marrin pjesë në garat ndërkombëtare të Kupave të EHF-it. Lojtarët apo lojtarët të cilët kalojnë nga klubi në klub për gara të Kupave të EHF-it duhet të bëjnë kalimet e tyre në përputhje me Rregulloren mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, statusi dhe transferimi i tyre.

6.15. Skuadrat janë të obliguara të kenë terminet e zhvillimit të ndeshjeve me orar dhe kohë të caktuar para fillimit të Kampionatit, kurse ato skuadra që e ndryshojnë terminin e zhvillimit të takimit janë të obliguara vetë të informojnë Komisararin e garave (gjegjësisht zyrën FHK-së), personat zyrtar dhe skuadrat kundërshtarë 48 orë para fillimit të ndeshjes mbi ndryshimin e terminit. Në rast të vonesës së ndryshimit nga skuadra vendas dhe mos informimit me kohë do të sanksionohet me 50 euro gjobë.

6.15.1. Ndërsa skuadrat të cilat për shkaqe të ndryshme i kanë palestrat apo fushat të zëra janë të obliguar që ndeshjet të zhvillojnë në terrenin – palestrën rezervë të cilën duhet ta paraqesin para fillimit të Kampionatit.

Përndryshe ndeshjen do të e humbin me rezultat zyrtar.

6.16. Komisari i garave mund të shtyjë ndeshjen e caktuar pa kërkesë të skuadrave vetëm në këto raste:

6.16.1. Fatkeqësisë elementare, ndalesës së organeve shtetërore, shëndetësore apo organeve lokale.

- 6.16.2. Në rastet e helmimit apo të sëmundjeve të më shumë se pesë (5) lojtarëve standardë, duke dëshmuar me raportin mjekësor të vërtetuar nga Enti përkatës shëndetësor.
- 6.16.3. Pjesëmarrjes së një apo më tepër lojtarëve në Kombëtaren e Kosovës apo në rastet kur këto ndeshje janë të parapara me programin dhe kalendarin e garave të FHK-së, apo lojtarëve në Përfaqësueset e tyre në garat e EHF-it dhe IHF-it.
- 6.16.4. Pjesëmarrjen e ekipeve në gara përfundimtare të Kupës së Kosovës apo gara të IHF-it ose EHF-it, në rast të ndeshjeve ndërkombëtare.

- 6.17.** Për hir të rregullsisë së garave Komisari i garave mund të vendosë që ndeshjet e caktuara apo të gjitha ndeshjet e dy xhirove të fundit të luhen në të njëjtën ditë dhe termin.
 - 6.17.1. Në ndeshjet e Kampionatit koha e pritjes së skuadrës është 30 minuta, skuadra e cila vonohet 30 minuta do të sanksionohet me 100€, në rast se është vonesa më e madhe (max 60 minuta), skuadra e cila vonohet sanksionohet me 200 € gjobë.
 - 6.17.2. Vëzhgues-kontrolluesi mund të shtyjë kohën e pritjes nëse lejojnë kushtet, të cilat ndikojnë në zhvillimin e ndeshjes si shfrytëzimi i sallës nga ekipet e tjera, mos prezenca e policisë apo të ngjashme më së shumti 30 minuta, por skuadra e cila është vonuar do të sanksionohet me 200 € gjobë.
 - 6.17.3. Në raste kur ndeshja shtyhet për shkak të mos dhënies së terminit të saktë nga skuadra vendase, apo është palestra e zen me ndonjë ndeshje të aktivitetit tjetër dhe ndeshja e paraparë të zhvillohet shtyhet deri në 30 minuta, skuadra vendase sanksionohet me 100 € gjobë, në rast se është vonesa më e madhe (max 60 minuta), skuadra vendase sanksionohet me 200 € gjobë.
 - 6.17.4. Nëse ndeshja për arsye objektive dhe të fuqisë madhore nuk mund të fillojë në terminin e caktuar do të pritet që kjo arsye të kalohet. Për këtë janë të autorizuar gjyqtarët, të cilët në konsultim paraprak me vëzhgues-kontrolluesin. Të gjitha këto të dhëna shënohen në procesverbal të ndeshjes. Ndeshja duhet të zhvillohet brenda 24 orëve të ardhshme dhe për këtë obligohet vëzhgues-kontrolluesi që në bashkëpunim me Përfaqësuesit e të dy klubeve ta cakton terminin zhvillimit të ndeshjes brenda 24 orëve dhe pastaj ta njofton edhe KG. Shpenzimet për zhvillimin e ndeshjes së re i bartë skuadra që është fajtores apo personat zyrtarë (vëzhguesi apo gjyqtarët) nëse janë shkaktarë i mos zhvillimit të ndeshjes.

- 6.18.** Të gjitha ndeshjet e mbetura gjatë sezonit vjeshtor duhet të zhvillohen para xhiros së fundit të këtij sezoni.
 Komisari i garave është i obliguar që të ndërmarrë masa që në parim, ndeshjet e shtyra të zhvillohen para xhiros së ardhshme të rregullt, përveç në rastet kur kemi të bëjmë me pjesëmarrjen e klubeve në garat e EHF-it apo kur vendos Komisari i garave në raste të veçanta. Në qoftë se për ndonjë arsye objektive nuk mund të zhvillohen ndeshjet e mbetura dhe mos zhvillimi i ndeshjeve ndikon në rregullsi atëherë Komisari i garave është i obliguar të shtyjë tërë xhiron e rregullt për një javë.

- 6.19.** Nëse ndonjëra nga ekipet jep dorëheqje nga garat e Kampionatit apo largohet nga ato, ndeshjet regjistrohen me rezultatet e arritura në terren:
 Nuk regjistrohen fare nëse ekipi ka zhvilluar më pak se 50% plus një ndeshje, dhe dënohet me 500€-1000€ gjobë.
 Regjistrohen me rezultat zyrtar 10:0 për ekipin kundërshtar nëse ekipi ka zhvilluar së paku 51% plus një ndeshje, dhe dënohet me 500€-1000€.
 Dhe ekipet që heqin dorë nga garat automatikisht bien në rangun më të ulët të garave.

- 6.20.** Skuadrat të cilat shpallën Kampion të Kosovës për edicionin 2025/26 në Superligën e meshkujve dhe Superligën e femrave janë të obliguar që të marrin pjesë në garat e Kupave të EHF-it për

edicionin 2026/27.

Skuadrat Kampione nëse marrin pjesë në garën përkatëse (Europa League) do të subvencionohen nga FHK-ja me të cilën e cakton Bordi i FHK-së.

Skuadrat të cilat paraqiten dhe aplikojnë për gara të EHF-it, duhet të sjellin dëshmitë se do të subvencionohen nga komunat e tyre me garancion apo të sponzorit dhe FHK-ja nuk bartë obligim për mbulimin e shpenzimeve. Në rast të mos paraqitjes në gara sanksionet e shqiptuara nga EHF-i skuadrës, skuadrat janë të obliguara ti bartin vetë të dënimet e shqiptuara dhe FHK-ja nuk merr asnjë obligim.

VII. Palestra Sportive

- 7.1. Ndeshjet e skuadrave të Superligës për meshkuj dhe femra, Ligës së parë për meshkuj dhe femra si dhe duke i përfshirë edhe skuadrat e të rinjve juniorë, kadetë dhe të pionierëve medoemos zhvillohen në palestrat sportive.
- 7.2. Palestrat duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - 7.2.1. Kapaciteti i zhvillimi të ndeshjeve të seniorëve duhet të jetë minimumi 500 shikues, të ketë minimumi një tribun anësore të gjatë
 - 7.2.2. Terreni duhet t'i ketë dimensionet 40 x 20 m, zona bazë 44 x 22 M. sipas kushteve të parapara me Propozicione të rregullave ndërkombëtare të hendbollit.
 - 7.2.3. Të jetë e pajisur me 16 ulëse (karrike) për skuadër,
 - 7.2.4. Vende të rezervuar për lojtarë të shkualifikuar me akçes të lehtë nga fusha e lojës
 - 7.2.5. Në palestra duhet të ketë dhoma zhveshjes përkatëse për përgatitjen e ekipeve dhe personave zyrtarë, sipas mundësive edhe ujë të nxehtë, si dhe lokale gjegjëse.
 - 7.2.6. Një dhomë të zhveshjes së gjyqtarëve, e pajisur me dush, ulëse dhe ujë në shishe të mbyllura (minimumi një litër për person)
 - 7.2.7. Tabela elektronike e rezultateve (minimumi 1 në anën e gjatë – përballë tryezës së gjyqtarëve ose 2 në secilën anë të shkurtër) e cila do të jetë e dukshme për ekipet dhe personat zyrtar.
 - 7.2.8. Tavolina e personave zyrtar dhe kohëmatësit :
 - Madhësia përafërsisht 3x0.70 m (numri i personave 4)
 - Tavolina e personave zyrtar dhe kohëmatësi nuk duhet të kalojë një gjatësi maksimale prej 4 m, pjesa e përparme e tavolinës duhet të jetë e mbyllur dhe të jetë e vendosur të paktën 0,5m larg vijave të zëvendësimit. Duhet të vendoset në nivelin 30 deri 40 cm mbi fushën e lojës, për të siguruar dukshmëri të qartë.
 - Hapësira për personat e mëposhtme do të rregullohet në tryezën e kohëmatësit:
Delegati i FHK-së, kohëmatësi, procesmbajtësi. Në rast të një delegati të dytë të emëruar nga FHK-ja, në rastet se organizohet edhe moderator i është i obliguar të vendoset mbrapa tavolinës së zyrtarëve.
 - Procesmbajtësi elektronik , mbajtësi i statistikave dhe kohëmatësi duhet të sigurohen nga klubi vendas.
 - Në të gjitha ndeshjet e Superligës, Ligës së parë dhe garave të grupmoshave të reja , duhet të disponohet një orë elektronike që lexohet lehtë nga tabela e kohëmatësit dhe mund të përdoret nga kohëmatësi; të jetë praktike për tu shënuar nga 0 deri në 30 minuta. Nëse është në gjendje të plotë pune, kjo pajisje do të autorizohet për matjen zyrtare të kohës në raste të problemve me tabelën e kohëmatësit. Një orë rezervë (me diametër 25 cm) që shfaq sekondat dhe minutat duhet të jetë në dispozicion.
 - Laptop me softuerin përkatës të raportit të ndeshjes digjitale, me lidhje të internetit dhe aksesë të energjisë elektrike në tabelën e kohëmatësit të cilin duhet të sigurojë skuadra vendase.

- Rrjetat e kapjes (20 x 7 m në të zeza) pas portave duhet të mbulojnë të gjithë vijën e jashtme të portës (minimumi i fiksuar në 3 m majtas dhe djathtas të golave; pozicionet e fotografëve duhet të merren parasysh). Rrjetat e kapjes duhet të fiksohen.
- 7.2.9. Temperatura minimale për zhvillimin e një ndeshje duhet të jetë së paku 16 gradë celsius.
- 7.2.10. Ndriçimi në palestër duhet të jetë minimumi 800 luksa, optimale 1200 -1500 luksa , kurse organizatori duhet të siguroi Aparaturën për matjen e ndriçimit sipas kërkesës së gjyqtarëve dhe vëzhguesit të ndeshjes.
- 7.2.11. Prapa tavolinës zyrtare në një vend sa më të përshtatshëm dhe qendror të vendoset flamuri kombëtar (shtetëror).
- 7.2.12. Hapësirën (tavolinën) e punës për skautizëm mbajtës të statistikave për të paktën një person dhe i cili ka akses në energji dhe lidhje me internet.
 - LED sistemin të reklamave (për ndeshet e pjesës gjysmëfinale dhe finale të Play off-it dhe FINAL4 të Kupës së Kosovës).
 - Hapësirën për vendosjen e komentatorit
 - Tribunen VIP
 - Dhomën VIP
- 7.2.13. Zonën për stafin mjekësor (afër fushës së lojës)
 - Zonën për vendosjen e kamerave
 - Qasje pa pengesë për personat me aftësi të kufizuara
 - Dalja e urgjencës
- 7.2.14. Hyrja e lojtarëve dhe e personave zyrtarë në terren duhet të jetë e siguar dhe e ndarë nga publiku
- 7.2.15. Çdo skuadër organizator i ndeshjes duhet të sigurojë 2 topa
- 7.2.16. Palestra sportive duhet te ketë qasje të rregullt në Internet, skuadra vendase është e obliguar që të siguroj internetin dhe laptopin për mbajtjen e procesverbalit elektronik (Online) ne bazë të programit të digjitalizimit të FHK-së.
- 7.2.17. Në palestrat sportive gjatë zhvillimit të ndeshjes është e ndaluar pirja e alkoolit, duhanit dhe e lëngjeve në shishe prej qelqi apo kanaqe.
- 7.2.18. Të gjitha palestrat duhet të jenë të regjistruara nga Komisari i garave.
- 7.2.19. Skuadrat e Superligës duhet të paraqesin palestrat rezervë si alternativë në rast se nuk mund të zhvillojnë ndeshjen për shkaqe objektive palestrat e tyre.
- 7.2.20. Skuadrat terrenet e të cilave nuk janë pranuar nga Komisari i garave janë të obliguara që ndeshjet t'i zhvillojnë në terrenet e pranuar ose nuk mund të marrin pjesë në gara.

VIII. Organizmi i ndeshjes

8.1. Takimi teknik

- 8.1.1. Skuadrat, personat zyrtar në palestër duhet të paraqiten një orë para ndeshjeve, skuadrat janë të obliguara te jenë ne palestër respektivisht ne zyrën ku përpilohet procesi ndeshjes. Ne takim teknik duhet te jenë prezent:
 - Përfaqësuesi i skuadrës vendase,
 - Përfaqësuesi i skuadrës mysafire
 - Vëzhguesi/kontrolluesi
 - Gjyqtarët
 Me takimin teknik udhëheq vëzhguesi i ndeshjes, në mungesë të vëzhguesit të ndeshjes takimin teknik e udhëheq gjyqtari i parë në protokoll.
- 8.1.2. Skuadrat duhet te sjellin nga një komplet te pajisjeve sportive (fanellat) me të cilat do ti zhvillojnë ndeshjet (një lojtari dhe portieri). Në lokalet ku hartohet procesverbali (elektronik) i ndeshjes mund të jetë prezent nga një përfaqësues i skuadrave, gjyqtarët, vëzhguesi, procesmbajtësi. Vërejtjet në regjistrimin e lojtarëve dhe vërejtjet e tjera bëhen para fillimit të ndeshjes në

- formularin e posaçëm të cilin e ka vëzhgues-kontrolluesi dhe nga një ekzemplar ju jepet të dy skuadrave.
- 8.1.3. Vëzhgues-kontrolluesi i ndeshjes është i obliguar ta ketë Listën zyrtare të lojtarëve të licencuar nga Komisioni për regjistrim të cilin e publikon Komisari i garave në Buletinin e radhës (për edicionin 2025/26) si dhe listën e lojtarëve të kontrollimit mjekësor për periudhën 6 mujore.
- 8.1.4. Pas përfundimit të ndeshjes shënohet dhe konstatohet paraqitja e ankesës për shkak të shkeljes së Rregullave të lojës së hendbollit e cila duhet të shkruhet me shkrim dhe argumentohet nga paraqitësi i ankesës.
- 8.1.5. Nëse skuadrat dhe personat zyrtar vonohen (nuk marrin pjesë) në takimin teknik duke respektuar nenin 8.1.1, Komisari i garave do të sanksioni si vijon:
- Vonesë deri në 15 minuta (skuadrës, personave zyrtar) i shqiptohet masa disiplinore vërejtje.
 - Vonesë deri në 30 minuta gjëbëhet me 50 € gjëbë.
 - Vonesë më shumë se 30 minuta skuadra, personat zyrtar do të sanksionohen me 100€ gjëbë.
- 8.1.5.1 Rreptësisht duhet të respektohet koha e fillimit të ndeshjes (çdo vonesë e skuadrave, personave zyrtarë ose arsye tjetër e vonesës së fillimit të ndeshjes, vëzhgues-kontrolluesi është i obliguar të konstatoi në protokoll të ndeshjes). Skuadra e cila nuk e respekton këtë, do të sanksionohet në bazë të vërejtjeve të vëzhgues – kontrolluesit më 100 € kurse gjyqtarët dhe vëzhgues-kontrolluesi 50€. Si arsyetim mund të merret vetëm shkresa zyrtare e organeve gjegjëse (p.sh. e policisë për ngecje aksidentale në trafik etj.) të cilën duhet ta siguron pala e cila nuk ka ardhur me kohë.
- 8.1.6. Në rast kur këto nuk i konstaton në formularin e posaçëm (formulari nr. 15) sipas apo nuk vepron në mbështetje të Propozicioneve të këtyre paragrafëve 8.1.1 deri më 8.1.4 Vëzhguesi (apo gjyqtari i parë në rast kur mungon vëzhguesi) gjëbëhet me 50 euro dhe mos delegim deri në përmbyshje të obligimit.
- 8.1.7. Në rast kur skuadra nuk i sjell pajisjet në takim teknik sipas nenit 8.1.2. dhe 8.1.3 do të sanksionohet me 50 euro gjëbë.
- 8.2.** Para fillimit të ndeshjes në takimin teknik sipas nenit paraprak 8.1 duhet t'i mundësohet vëzhgues-kontrolluesit në prezencën e përfaqësuesve të skuadrave, gjyqtarëve dhe procesmbajtësit, shikimi i lojtarëve të paraqitur për atë ndeshje në sistem elektronik, si dhe plotësimi i procesverbalit me lojtarë të rinj nëse ai nuk është plotësuar në mënyrën e paraprak të lojtarëve, sipas Rregullave të lojës së hendbollit.
- 8.2.1. Për të gjitha ndeshjet e Kampionatit ato të Kupës procesverbali krijohet nga lista e lojtarëve të futur në sistem nga klubi vendas dhe mysafir prej të cilëve origjinali i dorëzohet vëzhgues-kontrolluesit i printuar para ndeshjes i kompletuar dhe pas përfundimit të ndeshjes verifikohet nga vëzhguesi dhe duhet të printohet i kompletuar.
- 8.2.2. Nëse nuk veprohet sipas paragrafit 8.2.1, skuadra që nuk i ka futur lojtarët në sistem ose dështon ta mbajë sistemin elektronik do të gjëbëhet me 50 euro.
- 8.2.3. Të gjithë personat zyrtarë vërejtjet, raportet, ankesat etj. i dërgojnë të shtypura me shkronja të lexuara në formularët e posaçëm (Formularët 15,16,17 18,19 dhe 20) dhe janë të obliguar të ju dorëzojnë edhe të dy skuadrave edhe përmes email-it.
- 8.2.4. Nëse nuk veprohet sipas paragrafit ma lartë vëzhgues-kontrolluesi dënohet me 50 euro.
- 8.2.5. Të sigurohen kushtet normale për zhvillimin e ndeshjes e këtë në praninë e së paku katër kujdestarëve, të cilët rreth dorës mbajnë shenjën (shiritin) e kuq, në të kundërtën skuadra nikoqire sanksionohet me 100 €.
- 8.3.** Skuadra mikpritëse është i obliguar të njoftojë Policinë e Kosovës, të bëjë sigurimin e ndeshjes dhe të sigurojë prani të mjaftueshme të Policisë.
- Numrin e policëve varësisht nga rëndësia e ndeshjes e cakton stacioni përkatës i policisë.

- Në ndeshjet me peshë dhe rëndësi të veçantë minimumi i forcave të sigurisë (policisë) duhet të jetë 10 policë, për këtë para ndeshjes duhet të vendos vëzhguesi i ndeshjes një orë para ndeshjes në takimin teknik, dhe nëse nuk ka, të kërkon nga organizatori apo polici kryesor përforcime.
- Nëse policia nuk është prezentë skuadra nikoqire ndeshjen e humb me rezultat 0:10, por në rastet kur ka dëshminë përkatëse e vërtetuar nga SHPK-ja mbi paraqitjen e ndeshjes, ndeshja nuk humbet me rezultat zyrtar por ndeshja zhvillohet një ditë tjetër. Shpenzimet e skuadrës mysafire dhe të personave zyrtar i bartë skuadra nikoqire.
- Nëse edhe ditën tjetër kur e cakton terminin Komisari i garave, skuadra nikoqire nuk e siguron praninë e policisë, ndeshja humbet me rezultat zyrtar 0:10, pa marrë parasysh se e ka dëshminë mbi paraqitjen e ndeshjes në polici.

8.4. Vëzhgues – kontrolluesi është i obliguar të ju tërheqë vërejtjen përfaqësuesëve të skuadrave për ndonjë parregullsi licencimin e lojtarëve (Formulari nr. 17), kontrollimin mjekësor (Formulari nr. 18), apo ndonjë lëshim tjetër pa marrë parasysh se a ka dhënë vërejtje ekipi kundërshtar dhe këtë duhet të evidentojë në procesverbal të ndeshjes apo në formularin e posaçëm në të cilin duhet të nënshkruajnë përfaqësuesit e të dy skuadrave dhe gjyqtarët dhe ta marrin si dëshmi nga vëzhguesi.

8.4.1. Vëzhgues-kontrolluesi i cili nuk i vëren apo i vëren këto parregullsi dhe nuk i shënon dhe në procesverbal por është i obliguar këtë ta bëjë edhe në formularin e posaçëm të fletëparaqitjes do të gjobet me 100 €.

8.5. Skuadra vendëse është e obliguar të sigurojë ambulancën apo mjekun kujdestar për ndeshje, i cili është i licencuar dhe i cili duhet të jetë prezent 30 minuta para fillimit të ndeshjes, si dhe gjatë tërë kohës së zhvillimit të ndeshjes.

8.5.1. Vëzhguesi-kontrolluesi i ndeshjes është i obliguar që çdo shkelje eventuale të raportojë në formularin nr.19.

8.5.2. Nëse ndeshja vonohet më shumë se 15 minuta për këtë shkak skuadra nikoqire nuk e ka mjekun kujdestar (ambulancën) do të dënohet me gjobitje prej 100 €.

8.6. Personat zyrtarë në ndeshje duhet të jenë të veshur në mënyrë solemne, vëzhgues-kontrolluesi mund të mos bartë kollare, mirëpo veshja solemne serioze e obliguar. Kurse gjyqtarët janë të obliguar të kenë tri palë fanella me ngjyra të ndryshme nga brendi i sponzorit zyrtar të veshjeve të FHK-së KEMPA. Në rast të mos respektimit të kodit të veshjes gjyqtarët vëzhguesit – kontrollusi do të sanksionohet me 50€ gjobë.

8.7. Para fillimit të ndeshjes, përfaqësuesit zyrtarë të skuadrave i ofrojnë në shikim vëzhgues – kontrolluesit të ndeshjes listat e lojtarëve të printuara në procesverbal për atë ndeshje, të cilat duhet të jenë të licencuara nga organi kompetent për regjistrimin e lojtarëve.

8.7.1. Lojtari që nuk është i licencuar në sistem nuk ka të drejtë loje. Mund të paraqitet lojtari i cili më parë mund të identifikohet me mjete të tjera të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë etj.) por i cili është lojtarë/e i licencuar për edicionin 2025/26 sipas Listës së publikuar nga Komisari i garave, dhe listës së kontrollimit mjekësor, por që për shkak të gabimeve teknike nuk është i licencuar në sistem. Në këto raste duhet të kontaktohet Administratori i garave që lojtari të shtohet në listën e lojtarëve të licencuar në ndeshje.

- 8.7.2. Nëse lojtari nuk posedon asnjërën prej dokumenteve të identifikimit, atëherë vëzhgues-kontrolluesi obligohet të bëjë fotografimin e lojtarit, përmes celularit, ose fotografit të ndeshjes. Fotografinë e lojtarit/es, vëzhguesi-kontrolluesi duhet ta bashkangjes me dokumentet tjera përcjellëse të ndeshjes.
- 8.7.3. Vëzhgues-kontrolluesi duhet që të bëjë fletëparaqitjen për këto raste në formularin e posaçëm të (Formulari nr. 18) Komisarit të garave në të cilin duhet të nënshkruhet lojtari kontestues apo përfaqësuesi i klubit me të cili ata vërtetojnë se lojtari është i licencuar dhe marrin mbi vete të gjitha pasojat sipas Propozicioneve të garave dhe Rregullores disiplinore të FHK-së.
- 8.7.4. Vëzhguesit i ofrohen për shikim edhe listat e personave zyrtarë, të cilët duhet të jenë të vërtetuar dhe të licencuar, sepse pa këtë ata nuk mund të ulen në bankën rezervë e as të përfaqësojnë klubin. Asnjë person që nuk është në listën e personave të licencuar në sistem online nuk ka të drejtë paraqitjeje në ndeshje.
- 8.8.** Skuadra vendëse është e obliguar të sigurojë kushtet normale për zhvillimin e ndeshjes, të sigurojë sigurimin e kujdestarisë dhe shërbimin e sigurimit. Të njoftojë vëzhguesin për kujdestarin kryesor.
- 8.8.1. Për çdo ndryshim të terminit të paraparë me kalendar, skuadra vendëse është e obliguar të lajmërojë 48 orë më herët Komisarin e garave.
- 8.8.2. Skuadra vendëse (organizatori ndeshjes) është i obliguar të respektojë të gjitha aktet normative të FHK-së, rreth organizimit dhe zhvillimit të ndeshjes deri sa të gjithë pjesëmarrësit e saj nuk e lëshojnë palestrën (fushën).
- 8.8.3. Me kërkesë të skuadrës mysafire organizatori (skuadra vendëse) është i obliguar t'u garantojë siguri të plotë lojtarëve mysafirë dhe të gjithë personave zyrtarë, prej arritjes dhe deri tek dalja nga qyteti pas përfundimit të ndeshjes në mënyrë të organizuar.
- 8.8.4. Gjithashtu skuadra vendëse (organizatori i ndeshjes) është i obliguar ta caktojë personin përgjegjës për pritjen, shoqërimin dhe përcjelljen e personave zyrtarë (gjyqtarë dhe vëzhgues-kontrolluesin) prej momentit të arritjes dhe deri tek dalja nga qyteti pas përfundimit të ndeshjes. Nëse klubi nuk i plotëson këto kushte do të sanksionohet sipas nenit 14.15.
- 8.9.** Skuadra vendëse është e obliguar të sigurojë kushte optimale dhe të garantojë siguri për pjesëtarët e mjetëve të informimit (gazetarë të medimeve, qoftë të shkruara apo atyre elektronike), në qoftë se këta akreditohen dhe paraqiten te organizatori i ndeshjes para fillimit të takimit. Skuadra vendëse është e obliguar të sigurojë vendin e posaçëm për mjetet e informimit për ndjekjen e ndeshjes. Skuadra vendëse është e obliguar të ia mundësoi xhirimin e papenguar të ndeshjes çdo ekipi të interesuar.
- 8.9.1. Skuadrat e Superligës – tek meshkujt dhe femrat e kanë të obliguar të bëjnë video xhirimin e ndeshjes dhe me kërkesë të Komisarit të garave ta dorëzojnë në zyrën e FHK-së në rastet kur ka ankesë apo ndonjë vërejtje tjetër apo kur kjo kërkohet para zhvillimit të ndeshjes nga KG në Buletinin zyrtarë të radhës. Kurse Liga e parë e meshkujve dhe femrave si dhe rangjet e tjera sipas vendimit të Komisarit të garave të publikuar në Buletinin e radhës.
- 8.9.2. Xhirimi duhet të jetë në DVD, apo të dërgohet përmes formës elektronike dhe të jetë i nivelit profesional i paanshëm (mos të shkurtohet), dhe në kërkesë të KG ekipi vendas është i obliguar të e dorëzojë në zyret e FHK-së xhirimin ose ta publikojë në YouTube. Në të kundërtën do të merren masa në bazë të nenit 14.15.
- 8.10.** Klubet të cilat janë pjesëmarrëse në pjesën finale të Play off-it, janë të obliguar që ceremoninë e ndarjes së shpërblimeve të bëjë organizimin duke siguruar të gjitha mjetet përcjellëse për organizimin e saj siç janë (paraqitja e skuadrave në mënyrë solemne, zërmimi, mjetet tjera për mbarëvajtjen e rregullt të ceremonisë, mos respektimi i këtij neni do të sanksionohet me 200 € gjobë.

- 8.11.** Të gjitha ndeshjet e Superligës së meshkujve duhet të luhen me topa të përmasave 58 deri në 60 cm në perimetër dhe 425 deri në 475 g në peshë (madhësia IHF 3).
- 8.12.** Të gjitha ndeshjet e Superligës së Femrave duhet të luhen me topa të përmasave 54 deri në 56 cm në perimetër dhe 325 deri në 375 g në peshë (madhësia IHF 2)

IX. Obligimet në gara

- 9.1.** Shpenzimet e personave zyrtarë, të gjyqtarëve, vëzhgues-kontrolluesit (mëditjen dhe taksën) i paguan FHK nëpërmjet fletëpagesës të cilën personat zyrtarë (gjyqtarët dhe vëzhgues-kontrolluesit) i marrin nga Komisari i garave i FHK-së. Kurse shpenzimet e personave tjerë zyrtarë procesmbajtësit dhe kohëmatësit të cilët i cakton vendasi dhe shpenzimet e rrugës i bartë skuadra vendase.
- 9.2.** Para fillimit të ndeshjes bëhet përmbushja e obligimeve ndaj personave zyrtarë të takimit (shpenzimet e udhëtimit sipas urdhëresës së SHGJHK-së). Nëse skuadra vendëse nuk i përmbahet këtij neni, ndeshja nuk zhvillohet dhe skuadra vendës (apo ai mysafir që ka obligime) e humb ndeshjen me rezultat zyrtar, dhe njëkohësisht obligohet skuadra vendase që deri tek ndeshja e radhës ti paguajë personave zyrtarë shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet. Nëse skuadra nuk i përmbush obligimet por ndeshja zhvillohet, FHK-ja nuk merr asnjë obligim ndaj personave zyrtar për përmbushjen e tyre.
- 9.3.** Të gjitha skuadrat,e Superligës së meshkujve dhe Superligës së femrave deri me 15.10.2025- si dhe Ligës së parë të meshkujve dhe Ligës së parë të femrave deri më 15.10.2025- janë të obliguara të bëjnë pagesën në emër të pjesëmarrjes në gara si vijon:
- Superliga - meshkujt.....2,000 € (klubet i paguajnë 1,000€ kurse 1,000€ i bartë FHK)
 - Superliga – femrat1,500 € (klubet i paguajnë 750€ kurse 750€ i bartë FHK)
 - Liga e parë për meshkuj.....500 € (klubet i paguajnë 250€ kurse 250€ i bartë FHK)
 - Liga e parë për femra200 € (klubet i paguajnë 100€ kurse 100€ i bartë FHK)
 - Gjysma e shumës paguhet para fillimit të stinorit vjeshtor kurse gjysma tjetra para fillimit të stinorit pranveror.
- Skuadrat të cilat në gara kanë të inkuadruar edhe skuadrat e dyta në rangje më të ulëta të garave, lirohen nga pagesa e pjesëmarrjes.
- 9.3.1.** Shkollat e hendbollit të cilat inkuadrohen në rangjet më të ulëta të garave, lirohen nga pagesa e pjesëmarrjes. Skuadrat në Superligën e meshkujve të cilat paraqiten në gara me grupmoshat e reja: U12, U14, U16, U18 dhe U20, do tu rimbursohen pagesat e pjesëmarrjes në gara. Ndërsa skuadrat në Superligën e femrave të cilat paraqiten në gara me grupmoshat e reja: U11, U13,

- U15, U17, U19, do tu rimbursohen pagesat e pjesëmarrjes në gara. Njëkohësisht kjo vlen edhe për skuadrat e Ligës së parë meshkujve dhe Ligës së parë femrave.
- 9.3.2. Skuadrat te cilat inkuadrojnë në gara edhe skuadrat e dyta në rangë më të ulët, por nuk mund të fitojnë statusin e anëtarit të Ligës të rangut më të lartë edhe nëse bëhen kampion. Lojtarët mund të paraqiten për të skuadrat në rangje të ndryshme por jo në të njëjtën ditë. Skuadrat që paraqesin në gara skuadrat në rangje më të ulëta lirohen nga pagesa e pjesëmarrjes.
- 9.3.3. Pagesa e pjesëmarrjes (kuotizimi) për stinorin vjeshtor duhet të realizohet me datat 15.10.2025- kurse për stinorin pranveror në datat 01.02.2026- Pagesa bëhet në xhirollogarinë e FHK-së dhe për këtë duhet të paraqitet dëshmia.
- 9.3.4. Skuadra e cila nuk e bënë pagesën sipas paragrafit të lartcekur nuk mundet ta zhvillojë ndeshjen e radhës.
- 9.3.5. FHK deri sa nuk siguron sponsorin e ligës, skuadrat obligohen të përmbushin pagesën e kuotizimit, kurse pagesën e personave zyrtar (përveç shpenzimeve të udhëtimit) e përmbushë FHK, kurse në sigurimin e sponsorit, kuotizimet dhe personat zyrtar paguhen nga fondi i sponsorit të ligës.
- 9.4. Delegimin e personave zyrtarë të cilët janë anëtarë të FHK-së, për çdo ndeshje e bën Komisari i garave (gjyqtarët me propozim të Komisionit apo Komisarit për delegim të SHGJHK-së), kurse në formularin e posaçëm (Formulari nr. 22) është Urdhëresa zyrtare për kryerjen e detyrës dhe përmbushjen e pagesës së gjykimit të ndeshjes (shuma e mëditjeve, taksave) si vijon:
- Taksat për gjyqtarë dhe kontrollues në Superligën e meshkujve: 50 €
 - Taksa për vëzhgues 35 €
 - Taksat për gjyqtarë dhe kontrollues në Superligën e femrave: 35 €
 - Taksa për vëzhgues 25 €
 - Taksat për gjyqtarë dhe kontrollues në Ligen e parë të meshkujve: 25 €
 - Taksa për vëzhgues 20 €
 - Taksat për gjyqtarë dhe kontrollues në Ligen e parë të femrave: 20 €
 - Taksa për vëzhgues 15 €
 - Taksat për gjyqtarë dhe kontrollues në ndeshjet e juniorëve, kadetëve: 15 €
 - Taksa për vëzhgues 15 €
 - Taksat për gjyqtarë dhe kontrollues në ndeshjet e kadetëve të Liga e parë e meshkujve: 10 €
 - Taksa për vëzhgues 5 €
- Te gjitha shpenzimet e taksave dhe të mëditjeve të gjyqtarëve dhe të vëzhguesve, vëzhgues-kontrollues i bart FHK-ja.
- 9.5. Mëditjet e personave zyrtarë që janë të inkuadruar në gara, zyrtarët e FHK-se (administratës, komisioneve, përfaqësuesve etj.) në shume prej 25 €.
- 9.6. Taksat dhe mëditjet të cilat ju paguhen personave zyrtarë nga FHK-ja tatimohen dhe paguhet obligimet tatimore dhe trusti sipas ligjeve në fuqi.
- 9.7. Klubet të cilat organizojnë ndeshje miqësore janë të obliguar që ndeshjen ta lajmërojnë paraprakisht në FHK. Çdo mos paraqitje zyrtare e ndeshjes do të sanksionohet sipas Propozicioneve të Garave, të gjithë pjesëmarrësit në ndeshje përfshirë: persona zyrtarë, lojtar, trajner, janë të obliguar të respektojnë Propozicionet e Garave, mos respektimi eventuale sanksionohet. Sanksionet e shqiptuara në ndeshje miqësore kanë të njëjtën peshë si në ndeshje kampionale. Gjyqtarët e deleguar nga Komisari i garave në ndeshje miqësore duhet t'i mbulohen shpenzimet e rrugës dhe mëditja në nivel të FHK-së.

9.8. Ne edicionin e garave te Kampionatit te Kosovës do te aplikohet tarifa fikse e çmimeve (me poshtë e keni tabelën) e cila do te përcakton shumen e pagesës ne baze te largësisë nga vendi i udhëtimit deri tek vendi ku zhvillohet ndeshja. Tarifa vlen ne dy drejtimet (vajtje-ardhje), kurse ata persona zyrtare qe llogarisin me shume shpenzime se sa është ne çmimet e paraqitura ne tabelë, mjetet do ti kthejnë (Komisari do te bazohet ne Urdhëresën zyrtare (Formularin nr. 22), kurse do te sanksionohet me 100 € vëzhguesi i ndeshjes pasi është përgjegjës për plotësimin e Urdhëresës (Formularit nr. 22).

Bordi ka marrë vendim që kur kemi të bëjmë me qiftin e gjyqtarëve që delegohen nga i njëjti qytet, gjyqtarët nuk mund te marrin shpenzimet e rrugës në shumë të plotë por sipas kësaj tablele më poshtë, si edhe në rastet kur të tre personat zyrtarë (të dy gjyqtarët dhe vëzhgues-kontrolluesi) janë nga i njëjti vend.

TABELA 1

0 Shpenzimet e personave zyrtare (gjyqtarë v edhe vëzhgues) për edicionin 2025-26 prej vendit ku udhëton deri në vendin ku zhvillohet ndeshja																						
Vendi	Pr	Ob	Vu	Sa	Mi	Sk	Kaq	Kli	Ist	Pej	De	Gj	Ra	Prz	Sh	Fe	Lip	Gji	F.K	Dr	Po	Ma
Prishtinë		5	10	10	15	15	15	20	25	25	30	25	20	25	10	15	5	15	5	10	10	15
Obilic	5		5	5	10	10	15	20	25	25	30	30	25	25	10	15	10	15	5	10	10	15
Vushtrri	10	5		5	5	10	25	15	15	25	25	25	30	15	20	15	20	10	10	15	20	
Samadrexhë	10	5	5		10	10	25	15	15	25	25	25	25	30	15	20	15	20	10	10	15	20
Mitrovicë	15	10	5	10		5	25	15	15	20	25	25	25	30	20	20	15	25	15	15	15	20
Skenderaj	15	10	10	10	5		25	10	10	15	20	20	15	25	15	20	15	25	15	10	20	15
Kaqanik	15	15	25	25	25	25		30	35	35	35	15	25	25	10	15	15	15	15	20	25	20
Klinë	20	20	15	15	15	10	30		10	10	15	10	15	25	15	20	20	30	15	10	30	10
Istog	25	25	15	15	15	10	35	10		10	15	15	20	30	25	25	25	35	20	15	35	15
Pejë	25	25	25	25	20	15	35	10	10		5	15	15	25	25	30	25	35	25	20	35	20
Deçan	30	30	25	25	25	20	35	15	15	5		10	15	20	30	30	30	35	25	25	35	20
Gjakovë	25	30	25	25	25	20	15	10	15	15	10		10	15	25	30	25	35	25	20	35	15
Rahovec	20	25	25	25	25	15	25	15	20	15	15	10		10	15	20	20	30	15	15	30	5
Prizren	25	25	30	30	30	25	25	25	30	25	20	15	10		15	20	20	30	25	20	35	15
Shtime	10	10	15	15	20	15	10	15	25	25	30	25	15	15		5	5	15	10	10	20	10
Ferizaj	15	15	20	20	20	20	15	20	25	30	30	30	20	20	5		10	10	10	15	20	15
Lipjan	5	10	15	15	15	15	15	20	25	25	30	25	20	20	5	10		10	5	10	15	15
Gjilan	15	15	20	20	25	25	15	30	35	35	35	35	30	30	15	10	10		15	25	25	25
F.Kosovë	5	5	10	10	15	15	15	15	20	25	25	25	15	25	10	10	5	15		10	15	10
Drenas	10	10	10	10	15	10	20	10	15	20	25	25	15	20	10	15	10	20	10		20	10
Podujevë	10	10	15	15	15	20	25	30	35	35	35	35	30	35	20	20	15	25	15	20		25
Malishevë	15	15	20	20	20	15	20	10	15	20	20	15	5	15	10	15	15	25	10	10	25	

Vërejtje: Tabela 2 Kjo tabelë vlenë vetëm për vëzhgues-kontrolluesin apo njërin gjyqtarët që udhëton nga tjetër qytetit (vendi) tjetër diametralisht të kundërt p.sj. Podujevë – Gjilan etj.

TABELA 2

0 Shpenzimet e personave zyrtare (gjyqtarë v edhe vëzhgues) për edicionin 2025-26 prej vendit ku udhëton deri në vendin ku zhvillohet ndeshja																						
Vendi	Pr	Ob	Vu	Sa	Mi	Sk	Kaq	Kli	Ist	Pej	De	Gj	Ra	Prz	Sh	Fe	Lip	Gji	F.K	Dr	Po	Ma
Prishtinë		5	5	5	10	10	10	10	15	15	20	20	15	15	5	10	5	10	5	10	5	10
Obilic	5		5	5	5	10	15	15	15	15	20	20	15	15	10	10	5	10	5	5	5	10
Vushtrri	5	5		5	5	5	15	10	10	15	20	20	15	20	10	15	10	15	5	10	10	15
Samadrexhë	5	5	5		5	5	15	10	15	20	20	20	15	20	10	15	10	15	5	10	10	15
Mitrovicë	10	5	5	5		5	20	10	10	15	15	15	15	20	15	15	10	20	10	10	10	15
Skenderaj	10	10	5	5	5		20	5	5	10	15	15	10	20	10	15	15	20	10	5	15	10

Kaqanik	10	15	15	15	20	20		20	25	25	25	25	20	20	10	5	10	10	10	15	15	15
Klinë	10	15	10	10	10	5	20		5	5	10	5	10	15	10	15	15	20	10	10	20	5
Istog	15	15	10	15	10	5	25	5		5	10	10	15	20	15	20	20	25	15	15	20	10
Pejë	15	15	15	20	15	10	25	5	5		5	10	10	15	15	20	20	25	15	15	25	10
Deçan	20	20	20	20	15	15	25	10	10	5		5	10	10	20	20	20	25	20	15	25	10
Gjakovë	20	20	15	20	15	15	25	5	10	10	5		10	10	15	20	20	25	15	15	25	10
Rahovec	15	15	15	15	15	10	20	10	15	10	10	10		10	10	15	10	20	10	10	20	5
Prizren	15	15	20	20	20	20	20	15	20	15	10	10	10		10	15	10	25	15	15	20	10
Shtime	5	10	10	10	15	10	10	10	15	15	20	15	10	10		5	5	10	5	5	10	10
Ferizaj	10	10	15	15	15	15	5	15	20	20	20	20	15	15	5		5	10	10	10	15	10
Lipjan	5	5	10	10	10	15	10	15	20	20	20	20	10	10	5	5		10	5	10	10	10
Gjilan	10	10	15	15	20	20	10	20	25	25	25	25	20	25	10	10	10		10	15	15	20
F.Kosovë	5	5	5	5	10	10	10	10	15	15	20	15	10	15	5	10	5	10		5	10	10
Drenas	10	5	5	10	10	5	15	10	15	15	15	15	10	15	5	10	10	15	5		10	5
Podujevë	5	5	10	10	10	15	15	20	20	25	25	25	20	20	10	15	10	15	10	10		15
Malishevë	10	10	10	15	15	10	15	5	10	10	10	10	5	10	10	10	10	20	10	5	15	

X. Lojtarët në gara

10.1. Lojtari i cili nuk është regjistruar për edicionin garues në sistemin elektronik të FHK-së nuk mund të paraqitet në ndeshjet

10.1.1. Klubi përkatës është i obliguar që regjistrimin e lojtarëve të bëjë përmes formularit 3.1 të cilin e pranon nga Komisari i garave, dhe të njëjtit lojtar ti vendos në sistemin elektronik përmes qasjes në sistem duke futur këto të dhëna

- Logon e klubit
- Fotografinë e skuadrës, me madhësi 2880x960 px
- Fotografën e lojtarit për edicionin garues për lojtarët që gjinden në sistem
- Të dorëzojë certifikatën e lindjes, një foto të lojtarit/es 512x640 px me prapavijë të bardhë dhe formularin përkatës për lojtarin që janë regjistruar për herë të parë, sipas Rregullores për regjistrimin e lojtarëve dhe transferin e tyre
- Për lojtarët që vijnë me transferim ndërkombëtar, të dorëzojë formularin 7 dhe 10 dhe pasaportën së bashku me certifikatën e transferit ndërkombëtar.

Gjithashtu duhet të përfundojë kontrollin mjekësor në qendrën e mjekësisë sportive për tu konfirmuar nga zyra e FHK-së.

10.2. Të gjithë lojtarët e regjistruar duhet të kenë kontroll mjekësor sistematik të kryer. **Kontrolli mjekësor i lojtarëve, kryhet në QKMS, QENDRA KOMBETARE E MJEKËSISË SPORTIVE dhe Ordinanca Private** të cilat janë të licencuara nga Ministria e Shëndetësisë për Kontrolla sportive mjekësore dhe ai duhet të bëhet për secilin sezon para fillimit të tij (kontrolli mjekësorë nuk mund të jetë më e vjetër se gjashtë muaj), por një kopje e listës së të gjithë lojtarëve duhet të vërtetohet dhe dorëzohet në zyrën e FHK-së respektivisht Komisarit të garave në mënyrë elektronike. Nëse lojtari-ja nuk ka kontroll mjekësor të kryer e të evidencuar të mjekësisë sportive apo entit tjetër shëndetësor dhe të vërtetuar në formularin përkatës (ose nuk gjendet në listat e lëshuar nga institucioni përkatës me vulë të këtyre institucioneve në harmoni nga paragrafi 1. i këtij neni, ai nuk mund të paraqitet në lojë dhe gjithashtu nuk do të jetë i regjistruar në sistemin elektronik të garave. Nëse paraqitet, dhe skuadra kundërshtarë paraqet ankese pas ndeshjes

(Formulari nr. 17), ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar 10:0 në të mirë të skuadrës rivale, ndërsa skuadra do të dënohet në shumën prej 100 €.

10.2.1. Nëse skuadra nuk paraqet ankese pas përfundimit të ndeshjes, Komisari i garave lojtarin e paraqitur pa kontrollim mjekësor do ta ndëshkon me gjobë prej 100 €, edhe nëse nuk ankese nga skuadra kundërshtare në baze të fletëparaqitjes së vëzhgues-kontrolluesit i cili është i obliguar të evidenton këtë në formularin e posaçëm të FHK-së sipas Propozicioneve të garave por ndeshja nuk regjistrohet me rezultat zyrtarë.

10.3. Në ndeshjet e sezonit vjeshtor të drejtë loje kanë të gjithë lojtarët e regjistruar dhe të licencuar në mënyrë të rregullt të lindur më 2008- dhe më të vjetër, si dhe lojtarët më të rinj, mirëpo ata duhet ta kenë të kryer kontrollimin special mjekësor të cilën janë të obliguar të dërgojnë në zyrën e FHK-së dhe të vërtetohet me qëllim të vendosjes së tij në sistem për skuadrën seniore.

10.3.1. Nëse lojtari nuk e ka të evidencuar në librezë dëshminë se ka kryer vizitën speciale mjekësore para ndeshjes, përveç shikimit (kontrollit) të rregullt mjekësorë ekipi e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:10, dhe dënohet me 100 €. Dëshmia nuk mund të jetë më e vjetër se gjashtë muaj.

XI. Veshjet e sportive

11.1. Skuadrat duhet ti kenë dy palë fanellat primare dhe ato sekondare (ngjyrën e hapur dhe të mbylltë) dhe tri ngjyra fanella të portierëve në ngjyra të ndryshme (rregullojra e IHF) të cilat me rastin e regjistrimit në fillim të edicionit janë të obliguar që ta njoftojnë FHK-në për ngjyrat që do ti bartin. Me Buletin Zyrtar do njoftoheni për ngjyrat e secilës skuadër, dhe në rast të konfrontimit të ngjyrave gjatë kampionatit, skuadra e cila nuk ka fanella rezervë e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:10.

11.2. Përzgjedhja e veshje në takimin teknik në prezencën e dy klubeve bëhet skuadra vedase ka të drejtë të zgjedhë ngjyrën primare të lojtarëve, kurse skuadra mysafire në rast se ngjyra primare është e njëjtë me të skuadrës vendase atëherë është e obliguar të veshë ngjyrën sekondare. Kurse në rastet kur kemi të bëjmë me ngjyra të njëjta të portierëve të skuadrave vendim merr vëzhguesi se çfarë ngjyre duhet të veshë.

11.3. Një lojtar duhet të mbajë të njëjtin numër në ndeshjet e Kupës Evropiane të EHF të gjithë sezonit. Ky numër nuk lejohet të përdoret nga asnjë lojtar tjetër.

11.4. Ngjyra e skuadrës publikohet në Buletinin zyrtar para fillimit të garave. Fanellat duhet të kenë numrat në shpinë në madhësi prej 20 cm, kurse në gjoks 10 cm, dhe numrat e lojtarëve në fanella duhet të jenë identik me numrat e shënuar në procesverbal. Numrat mund të jenë prej 1 deri 99 do të sanksionohet sipas nenit 14.2.

11.5. Skuadrat duhet të kenë fanellat dhe çorapet e njëjta e jo laramani, me numra në shpinë dhe në gjoks. Personat zyrtar të Klubit (trajneri, përfaqësuesi zyrtar, fizeoterapeuti, etj) të ulur në bankinën e klubit nuk duhet të kenë laramani. Në rastet e evidentimit të mos përmbajtjes së

këtij nenin skuadra do te sanksionohet sipas nenin 14.2

- 11.6.** Reklamimi në rrobat e ndeshjeve dhe stërvitjes së lojtarëve lejohet në ndeshjet e Superligave dhe Ligave të para në përputhje me Rregulloren e Reklamimit në Veshje. Skuadrat janë të obliguar që në anën e djathtë të krahut të vendosin **llogon e FHK-së**, në raste se kërkohet të vendoset llogon e ligës apo sponsorit të ligës.
- 11.7.** Nuk lejohet shfaqja e logove të ndryshme të sponsorëve kryesorë në pjesën e përparme të fanellës si dhe në pjesën e pasme të fanellës. Shfaqja e një logoje të ndryshme shtesë të sponsorit në pjesën e përparme dhe në anën e pasme të fanellës së lojtarëve të ndryshëm është e mundur, megjithatë, të gjitha ato logo të ndryshme duhet të kenë të njëjtën ngjyrë dhe të njëjtën madhësi. Logot që ndryshojnë pamjen e përgjithshme të fanellës nuk lejohen.
- 11.8.** Gjyqtarët duhet në ndeshje të paraqiten me uniforma të njëjta (fanella sportive, brekë, atlete, çorapë etj.) dhe duhet ti kenë nga tri palë me ngjyra të ndryshme, kurse vëzhgues-kontrolluesit e ndeshjeve në Superligë të jenë me kostume dhe kollare (nuk është e obliguar) si dhe të pajisen me shenjë identifikuese të FHK-së.
Çdo mos përmbajtje e këtij neni sjell sanksione prej 50 €.
- 11.9.** Vëzhgues – kontrolluesi obligohet që një orë para fillimit të ndeshjes (në takimin teknik) të kontrollojë ngjyrat e fanellave të lojtarëve (lojtareve) sipas alinesë 1 të këtij neni, ku skuadrat janë të obliguar të sjellin në takimin teknik të organizuar nga skuadra vendase dhe kurrësi në çastin e fundit para fillimit të ndeshjes do të sanksionohet sipas nenit 15.7

XII. Trajnerët në gara

- 12.1.** Klubet pjesëmarrës në edicionin 2025-26, janë të obliguar të kenë të paktën një zyrtar të licencuar për secilën skuadër si trajner me licencë të vlefshme sipas Rinck Konventës.
- 12.2.** Klubet pjesëmarrës në të gjitha ligat do t'i komunikojnë Zyrës së FHK-së Fletën e Aplikimit për Licencimin e Trajnerëve të SHTHK-së (duke përdorur formularin zyrtar të FHK-së), nëpërmjet Shoqatës së Trajnerëve. Shoqata e Trajnerëve do të konfirmojë që trajneri(t) përmbushin kërkesat e kategorive përkatëse të EHF Rinck Konventës (Manuali i Zbatimit të Licencimit të Trajnerëve të EHF dhe Manuali i Konventës Rinck).
- 12.3.** Skuadrat e Superligës duhet të kenë trajner të licencuar me licencë A (master coach) dhe B (level III), skuadrat e Ligës së parë dhe të dytë trajner me licencë C (Level II) dhe D (Level I), trajnerëve të cilët janë në shkollim apo në përfundim të shkollimit ju mundësohet udhëheqja e skuadrave nëse në afat prej 6-të muajsh përfundon shkollimin në të kundërtën ju merret licenca e përkohshme, kurse ai klub trajneri i të cilit nuk disponon më të duhet pagojë në fondin e SHTHK-së, për të marrin licencë të përkohshme SHTHK-së për të udhëheqë klubin për atë edicion garues si vijon:
- 12.3.1. 500 € për trajnerët që udhëheqin skuadrat e Superligës së meshkuj me kusht që ka vijuar tre Seminaret e fundit të organizuara nga SHTHK-ja.
- 12.3.2. 250 € për trajnerët që udhëheqin skuadrat e Superligës së femrave me kusht që ka vijuar tre Seminaret e fundit të organizuara nga SHTHK-ja.
- 12.3.3. 100 € për trajnerët që udhëheqin skuadrat e Ligës së parë meshkuj dhe femra, juniorë, kadetë dhe pionierë me kusht që ka vijuar tre Seminaret e fundit të organizuara nga SHTHK-ja.

- 12.3.4. 200 € për trajnerët që nuk janë shtetas të Kosovës edhe nëse e ka licencën valide.
- 12.3.5. Mjetet e grumbulluara nga këto gjopa ekskluzivisht shkojnë në konton e SHTHK-së, dhe duhet të përdorën për ngritjen profesionale të anëtarëve të SHTHK-së.
- 12.4.** Skuadrat e Superligës për meshkuj dhe femra janë të obliguara që të kenë kontrata të vlefshme me trajnerët në bazë të akteve normative të klubeve dhe Ligjit përkatës, kontrata të cilat vërtetohen edhe në SHTHK-ë, dhe për çdo mos përmbushje të kontratës trajneri apo klubi duhet ti drejtohet Gjykatës kompetente Themelore.
- 12.5.** Trajneri i cili udhëheqë skuadrën e kadetëve (kadeteve) apo të juniorëve nëse paraqitet tek skuadra seniore si lojtarë, në rast se ndëshkohet me kartuç te kuqë apo ka fletëparaqitje nuk ka te drejtë lojë ne te njëjtën ditë. Nëse paraqitet ne proces te ndeshjes se juniorëve e humb ndeshjen me rezultat zyrtarë 0:10.
- 12.6.** Trajneri i cili udhëheqë skuadrën juniorëve, dhe nëse ndëshkohet me karton te kuq, apo pezullohet nuk ka te drejtë te paraqitet ne skuadrën e seniorëve nëse zhvillohet atë ditë.
- 12.7.** Të gjitha skuadrat e Superligës në të dy konkurrencat janë të obliguar që në bankën e tyre të kenë trajner të licencuar me licencë përkatëse të cilin e lëshon SHTHK-ja për një vit garues. Çdo skuadër duhet të ketë së paku dy trajner të licencuar, një për skuadrën e parë e një për grup moshat e reja.
- Skuadrat që nuk ka trajner të licencuar gjatë zhvillimit te ndeshjes ne bankina, sipas Rregullores së SHTHK-së do të gjobiten:
- me 50 € për ndeshje skuadrat e Superligës (femra dhe meshkuj)
 - me 50 € për ndeshje skuadrat e Ligës së parë (femra dhe meshkuj)
- Nëse edhe në ndeshjen e dyte paraqiten pa trajner të licencuar dënohen me 100 euro.
- Mjetet e inkasuar nga këto gjopa ekskluzivisht shkojnë në konton e FHK-së, dhe duhet të përdorën për ngritjen profesionale të anëtarëve të SHTHK-së.
- 12.8.** Trajnerët në Ligën e Fatosëve dhe Ligën U12 janë të obliguar që të jenë trajnerë të cilët nuk janë të licencuar në Kategoritë e tjera si Liga e Pionierëve, kadetëve, juniorëve apo seniorëve. Licencimi i trajnerëve në Ligën e Fatosëve do të jetë 20 euro.
- 12.9.** Licencimi i trajnerëve është i obliguar dhe bëhet 15 ditë para fillimit te Kampionatit ne Seminarin qendror të SHTHK-së nga data 30.08.2025. Nëse skuadra nuk e dërgon trajnerin ne Seminar i cili është i obligueshëm për trajner me qenë pjesëmarrës, çdo licencim i mëvonshëm kushton me gjobë prej 100 euro Superliga e meshkujve, 100 euro Superliga e femrave dhe 50 euro Ligat e tjera.

XIII. Zyrtarët e FHK-së

- 13.1.** Zyrtarët e FHK përfshijnë gjyqtarët, delegatët, delegatët e gjyqtarëve, përfaqësuesit, mbikëqyrësit e marketingut të FHK-së, stafi i zyrës së FHK dhe çdo person tjetër të emëruar nga FHK në lidhje me një ndeshje të organizuar në kuadër të garave zyrtare të FHK-së
- 13.1.1. Zyrtarët e FHK-së të emëruar nga FHK veprojnë në përfaqësim të FHK-së. Ata mbikëqyrin zhvillimin e ndeshjeve, duke ndjekur kërkesat e FHK. Ata i ofrojnë FHK-së raportet e garave në mënyrë që të informojnë për zbatimin korrekt të kërkesave teknike, procedurave dhe organizimit. Këto raporte të zyrtarëve të FHK-së janë bazë për procedurat ose sanksionet e mundshme disiplinore ndaj klubeve, personave zyrtar dhe të gjithë anëtarëve të përfshirë në garë.

13.2. Delegimi

- 13.2.1. FHK ka të drejtë të emërojë zyrtarë të FHK-së në të gjitha garat zyrtar të organizuar nga FHK
- 13.2.2. Klubet do të informohen me kohë përpara ndeshjes për nominimin të zyrtarëve të FHK-së
- 13.2.3. Përveç gjyqtarëve, delegatit dhe delegatit të gjyqtarit , FHK ka të drejtë të emërojë zyrtarë të tjerë kryesisht në fushën e marketingut dhe organizimit/sigurisë së ngjarjes. Detyrat dhe kompetencat e këtyre zyrtarëve shtesë do të përcaktohen për emërimin individual.
- 13.2.4. Delegimi i personave zyrtarë në edicionin 2025/26. do të bëhet në bazë të ranglistës së SHGJHK-së sipas rezultateve të testimit mbi njohurin e Rregullave të lojës së Hendbollit, kurse për vëzhgues dhe vëzhgues-kontrollues edhe mbi njohurin e Propozicioneve të garave.
Pjesëmarrja e gjyqtarëve dhe vëzhgues dhe vëzhgues-kontrolluesve në Seminarin qendror të edicionit 2025/26 është i obliguar, sikur edhe seminarët tjerë që organizon SHTHK-ja gjegjësisht FHK-ja për të gjithë personat zyrtarë gjatë edicionit 2025/26.
- 13.2.5. Kush nuk merr pjesë në Seminare do të ndëshkohet sipas vendimeve të Këshilli Drejtues i SHGJHK-së, dhe nuk delegohet deri të mbahet ritestimi.
Ritestimi për ata që tregojnë rezultate negative në Seminarin qendror organizohet pas një muaji, kurse ata që nuk marrin pjesë fare në Seminarin qendror testimi i ri organizohet 07/08.10.2025 .
Mos pjesëmarrja automatikisht sjell mos përfshirje në Listën e personave zyrtarë për edicionin 2025/26.

13.3. Vëzhguesi, Vëzhguesi -kontrolluesi

- 13.3.1. Vëzhguesi – kontrolluesi do të verifikojë dhe sigurojë zhvillimin e rregullt të ndeshjes para, gjatë dhe pas ndeshjes dhe parandalon çdo dukuri që mund të çojë në një ankesë ose përsëritje. Zyrtari i FHK-së-së ka detyrimin të kontaktojë menjëherë FHK-në. Siguria dhe siguria e lojtarëve, gjyqtarëve, delegatëve dhe spektatorëve duhet të jetë në nivelin e duhur. Duhet të merren të gjitha masat që janë të nevojshme për të ruajtur sigurinë. Do të zbatohen dispozitat e Rregullave për Procedurën e Sigurisë të parapar me këto propozicione dhe me Ligjet në fuqi.
- 13.3.2. Një delegat nuk është një gjyqtar kryesor. Përgjegjësia në fushën e lojës bie vetëm tek gjyqtarët. Megjithatë, delegati do të ndërpresë ndeshjen nëse është e nevojshme dhe do të jep rekomandime që mund të çojnë në zhvillim e garës në rregull. Vepimet e tij në këtë kontekst nuk nënkuptojnë vendime të marra nga gjyqtarët bazuar në vëzhgimin vendimin e tyre të gjykuar. Vëzhguesi – kontrolluesi nuk do të marrë vendime, por vetëm do të bëjë rekomandime. Kur është në detyrë, vëzhguesi duhet të ketë gjithmonë një kopje të Propozicioneve të garave FHK-së, si dhe Rregullat e lojës.
- 13.3.3. Vëzhguesi – kontrolluesi i deleguar zyrtarisht duhet të ulët gjithmonë në tryezën e kohëmatësit për të pasur një pamje të mirë të zonës së zëvendësimit në çdo kohë dhe për të qenë në gjendje të ndërhyjë nëse është e nevojshme (shih Rregulloret e Zonës së Zëvendësimit të IHF-së).
- 13.3.4. Vëzhguesi – kontrolluesi i gjyqtarëve që është i nominuar në ndeshje, është detyrë e tij/saj të udhëzoj gjyqtarët gjatë gjithë qëndrimit nga mbërritja e tyre në palestër deri në largimin e tyre
- 13.3.5. Vëzhguesi – kontrolluesi është i obliguar që të kryej këto detyra:
- Kontrollin e sallës së lojës
 - Mbajtjen e takimit teknik
 - Përgatitjen e raporti të ndeshjes në bashkëpunim me klubet vendas dhe mysafir, kontrollin e fanellave një orë para fillimi të ndeshjes
 - Përgatitjen dhe kontrollin përfundimtar i pajisjeve të tavolinës së kohëmatësit
 - Kontrollin e programit të ndeshjes
 - Aspektin e sigurisë brenda dhe rreth sallës së lojës
 - Planin i përgjithshëm i aktivitetit rreth lojës

- 13.4.** Në raste të shkualifikimit të një apo më shumë lojtarëve në ndeshje, vëzhguesi është i obliguar që pas përfundimit të ndeshjes t'i marrë deklaratat me shkrim të lojtarëve të përjashtuar (Formulari nr. 21) , si dhe të evidentoj në procesin elektronik të ndeshjes.
Përjashtim nga alineja paraprake bëjnë lojtarët e përjashtuar nga loja (3 x 2 min).
Deklaratat e lojtarëve duhet të jenë të nënshkruara nga vetë lojtarët e shkualifikuar dhe deklaratat e tyre (në formularin e posaçëm që është i obliguar dhe duhet ta ketë vëzhgues-kontrolluesi janë pjesë përbërëse e procesverbalit).
Nëse vëzhguesi nuk ka mundësi të marrë deklaratën e lojtarëve të shkualifikuar, ai është i obliguar në Raport të theksojë e në procesverbal t'i tregojë arsyet e veprimit, të cilat kanë shkaktuar mungesën e deklaratave, ndërkaq ekipi është i obliguar që në afatin prej 48 orësh pas përfundimit të ndeshjes, deklaratat t'ia përcjellë Komisarit të garave (zyrës së FHK-së).
- 13.5.** Nëse vëzhguesi nuk është prezent në ndeshje, atë e zëvendëson me të gjitha të drejtat dhe obligimet e ushtron gjyqtari i parë i deleguar. Personi zyrtar mund të japë dorëheqje më së voni 72 orë para fillimit të ndeshjes me shkrim, ndërsa arsyen e dorëheqjes e vlerëson Komisari i garave. Për dorëheqje të paarsyeshme të personave zyrtar (gjyqtarëve dhe vëzhgues – kontrolluesve) pasojnë masat disiplinore në mbështetje të dispozitave të Rregullores mbi masat disiplinore të FHK-së. Dorëheqjen e vëzhgues – kontrolluesit e vlerëson dhe e zëvendëson Komisari i garave.
- 13.6.** Dorëheqja e parë gjatë një edicioni të garave e pa argumentuar dhe që nuk është bërë me shkrim, dhe në afatin e paraparë do të sanksionohet nga Komisari i garave prej 1-2 ndeshje mos delegim dhe me 50 € gjobë.
Dorëheqja e dytë gjatë një edicioni të garave e paargumentuar dhe që nuk është bërë me shkrim, dhe në afatin e paraparë do të sanksionohet nga Komisari i garave prej 2-4 ndeshje mos delegim dhe me 100 € gjobë.
Dorëheqja e tretë gjatë një edicioni të garave e paargumentuar dhe që nuk është bërë me shkrim, dhe në afatin e paraparë do të sanksionohet me pezullim nga Komisari i garave deri në përfundim të edicionit garues 2025/26.
Dorëheqjen e gjyqtarit e vlerëson dhe e zëvendëson Komisari i garave.
- 13.7.** Gjyqtarët dhe vëzhgues kontrolluesit të cilët janë aktiv në listat e EHF-it dhe IHF-it te cilët gjatë një edicioni i kanë tri (3) dorëheqje të paarsyeshme, automatikisht FHK-ja nuk do ti delegon në listat e EHF-it t për edicionin 2026/27.
- 13.8.** Procesverbalin e ndeshjes mund ta mbajë edhe personi zyrtar që nuk është nga vendi ku zhvillohet ndeshja për çka është i verifikuar. Nëse gjyqtarët e deleguar japin dorëheqje, ata zëvendësohen me çiftin rezervë të caktuar nga Komisari i garave, nëse edhe ata nuk vijnë, përkatësisht nuk janë prezentë, atëherë në marrëveshje me përfaqësuesit e klubeve do t'i zëvendësojë çifti i gjyqtarëve të sprovuar, i cili është prezent në palestër ose fushë dhe i cili është në listën e gjyqtarëve të kësaj kategorie.
Nëse nuk arrihet marrëveshja ndërmjet dy skuadrave që ndeshjen ta drejtojnë gjyqtarët prezentë, atëherë ata i cakton vëzhguesi pa pëlqimin e ekipeve.
Skuadra e cila nuk zhvillon ndeshjen apo refuzon të zhvillojë ndeshjen, e humb ndeshjen me rezultat 10:0 dhe dënohet me 200 €.
Në rast të mungesës së njërit gjyqtar të deleguar, ndeshjen e drejton gjyqtari tjetër prezent.
Nëse në ndeshje nuk është prezent asnjë çift i gjyqtarëve, ndeshja nuk do të zhvillohet, ndërsa Komisari i garave do të caktojë terminin të ri për zhvillimin e ndeshjes pas shqyrtimit të materialit të kompletuar.

- 13.9.** Gjyqtarët dhe vëzhguesi apo kontrolluesi janë të obliguar të jenë në palestër (të përgatitur në pajisje sportive), 30 minuta para fillimit të ndeshjes për arsye të kontrollimit të palestrës, përkatësisht të fushës dhe kushteve të tjera.
- 13.9.1.** Gjyqtarët dhe vëzhguesi apo kontrolluesi janë të obliguar të nënshkruajnë procesverbalin e ndeshjes, duke përshkruar të gjitha momentet kontestuese të ndeshjes (shkualifikimit, shkualifikimit me Raport, fletëparaqitjet (Formulari nr. 19), arsyen e vonesës së fillimit të ndeshjes si dhe arsyen e vonesës së personave zyrtarë), përveç shkualifikimit për shkak të përjashtimit 3 x 2 in, sjelljet josportive të gjithë pjesëmarrësve, si dhe sqarimet rreth ankesës së paraqitur në gjykim apo për ndeshjen e ndërprerë ose ndeshjen që është zhvilluar në formularin e posaçëm (Formulari nr. 20) që duhet ta ketë vëzhgues-kontrolluesi i ndeshjes. Po kështu vepron edhe vëzhguesi, i cili edhe më hollësisht shtjellon rrjedhën e ndeshjes dhe nuk mundet të shkruan në fletëparaqitje “pajtohem me deklaratën e gjyqtarit” të gjitha këto dokument vëzhguesi – kontrolluesi dhe gjyqtarët janë të obliguar që pas përfundimi të ndeshjes ti dërgojnë pa emër email-it zyrës së FHK-së dhe klubeve të involvuar në afat prej 30 minutave pas përfundimit të ndeshjes .
- 13.9.2.** Për mos përmbajtje të këtyre detyrave dhe mosardhjen me kohë, personat zyrtar do të ndëshkohen me gjobite prej 100 euro.
- 13.9.3.** Për mos përmbajtje të këtyre detyrave dhe mosardhjen me kohë për herë të dytë gjatë një edicioni të garave, personat zyrtar do të ndëshkohen me gjobitje prej 200 € gjobitje.
Për mos përmbajtje të këtyre detyrave dhe mosardhjen me kohë për herë të tretë gjatë një edicioni të garave, personat zyrtar do të pezullohen deri në përfundim të edicionit të garave 2025/26.
- 13.10.** Vëzhguesi apo vëzhgues-kontrolluesi dhe gjyqtarët janë të obliguar më së voni 24 orë pas përfundimit të ndeshjes t'ia dorëzojnë procesverbalin e ndeshjes Komisarit të garave përmes email-it të skanuar në formë PDF . Procesverbali duhet të përpilohet pas përfundimit të ndeshjes në prani e gjyqtarëve, procesmbajtësit, matësit të kohës, përfaqësuesve zyrtarë të skuadrave, mjekut dhe kujdestarit kryesor.
Në rast të mos funksionimit të sistemit elektronik të përpunimit të procesverbalit vëzhguesi kontrolluesi është i obliguar që të mbaj të dhënat dhe manual së bashku me procesmbajtësin.
Procesverbali i përgatitur sërish verifikohet me nënshkrimet e personave zyrtarë, por pa plotësime dhe ndryshime nga i mëparshmi.
- 13.11.** Vëzhguesit apo vëzhgues – kontrolluesit e ndeshjes janë të obliguar që më së shumti pesë (5) minuta pas përfundimit të ndeshjes të lajmërojnë zyrën e FHK-së (kujdestarinë) mbi përfundimin e ndeshjes me të dhënat elementare - rezultatin me anë të mesazhit të shkruar.
- 13.11.1.** Numri kontaktues i dërgimit të rezultatit përfundimtar dhe atij të pjesës së parë me mesazh të shkruar është 044/508 996 ose 045/620 300.
- 13.11.2.** Vëzhguesi apo vëzhgues – kontrolluesi i ndeshjes është i obliguar që pas përfundimit të ndeshjes të bëjë vlerësimin e gjyqtarëve. Formulari i vlerësimit të gjykimit (Formulari nr. 23) duhet të dërgohet në FHK për mes postes elektronike kg@kosovahandball.info në afat prej 48 orëve. Obligohen vëzhgues-kontrolluesit që edhe gjyqtarëve të ju dërgojnë vlerësimin mbi gjykimin e ndeshjes me post elektronike.
- 13.11.3.** Gjyqtarët obligohen që pas ndeshjes të bëjnë bisedën lidhur me vlerësimin nga ana e kontrollues-vëzhguesit.
- 13.11.4.** Vëzhguesit apo vëzhgues-kontrolluesi i ndeshjes është i obliguar që bashkë me procesverbalin e ndeshjes ta dorëzojnë edhe raportin mbi vëzhgimin e ndeshjes, kurse vlerësimin e gjyqtarëve me anë të postës elektronike në këtë e-mail: kg@kosovahandball.info më së largu 48 orë pas ndeshjes.
- 13.11.5.** Komisari i garave në Buletinin e radhës do të publikon edhe vlerësimin e gjyqtarëve.

- 13.11.6. Kush nuk i përmbahet këtij neni do të dënohet me 50 € gjobë, kurse në rastet e përsëritura dënimi do të jetë progresiv 100 €.
- 13.12.** Komisari i garave në bazë të cilësisë, rëndësisë dhe peshës së ndeshjes do të përcakton numrin e ndeshjeve që mund të drejtojnë vëzhguesit, kurse në ndeshjet të peshës më të rëndë do të delegohen vëzhgues - kontrolluesit duke marrë për bazë rezultatet nga testi mbi njohurinë e Rregullave të lojës, testite mbi njohjen e Propozicioneve të garave për edicionin 2025/26, në Seminarin qendror i cili organizohet para fillimit të edicionit 2025/26, dhe është i obligueshëm për të gjithë personat zyrtarë që gjenden në Listat për edicionin 2025/26.
- 13.13.** Në listën e vëzhgues-kontrolluesëve do të jenë edhe gjyqtarët me thirrje të EHF-it dhe IHF-it të cilët do të jenë persona zyrtarë në rangjet më të ulëta si Ligën e parë të femrave dhe meshkujve, juniorëve etj.
Vëzhguesit në Listën e FHK-së për edicionin 2025/26- do të përzgjidhen pas mbajtjes së testeve mbi njohurinë e Rregullave të lojës së Hendbollit dhe Propozicioneve të garave. Vëzhguesit do të përzgjidhen në bazë të performancave, përvojës në hendboll si lojtar, trajner etj.
- 13.14.** Komisari i garave e përcakton se në cilat ndeshje duhet të ketë vëzhgues-kontrollues apo vetëm vëzhgues në bazë të vlerësimit të peshës dhe rëndësisë së ndeshjes.
- 13.15.** Kurse delegimi i gjyqtarëve po ashtu do të bëhet sipas kategorizimit, testit të Rregullave të lojës dhe testit fizikë. Gjyqtarët për të drejtuar ndeshjet i propozon Komisioni (apo Komisari) për delegim i SHGJHK-së, në bazë të performancave të gjyqtarëve, rëndësisë dhe peshës së ndeshjes si dhe në bazë të rezultateve të treguara në testin fizikë dhe atë mbi njohjen e Rregullave të lojës. Kurse Komisari i garave mund të ndryshon propozimin e Komisarit për delegim, por në këto raste duke e informuar me shkrim për arsyet e zëvendësimit.
- 13.16.** Pas çdo ndeshje vëzhguesit dhe kontrolluesit janë të obliguar që ta plotësojnë formularin mbi vlerësimin e gjyqtarëve (nr. 23) pa marrë parasysh a kanë qenë kontrollues. Vlerësimin e tyre e bënë personi i autorizuar i SHGJHK-së mbi vlerësimet e gjyqtarëve Vlerësuesi i gjyqimit (i cili zëvendëson Komisionin profesional të SHGJHK-së).
- 13.17.** Komisari i garave nëse është gjyqtarë aktiv apo person zyrtar aktiv, nuk mund të delegohen apo të licencohen edhe në funksionet tjera si persona zyrtarë në gara për edicionin 2025/26.
- 13.18.** Anëtarët e Bordit të FHK-së nëse janë persona zyrtarë aktiv të klubeve, nuk kanë të drejtë të përfshihen në zyrtarisht në ndeshje me qëllim të ruajtjes së integritetit të tyre.
- 13.19.** Gjyqtarë, Vëzhguesit, Vëzhguesit – kontrolluesit janë të obliguar që në raste të delegimi apo angazhimi të informojnë Komisarin e garave 7 ditë përpara ose më së voni deri para mbajtjes së mbledhjes së Komisarit të garave. Në rast të dorëheqjes më vonese dorëheqja apo njoftimi do të konsiderohet i pa arsyeshëm i cili do të sanksionohet me 1-3 ndeshje mos delegim dhe 50 euro gjobë.
- 13.20.** Skuadra ka të drejtë të kërkojë super-kontroll apo vëzhgues të dytë, më së voni tri (3) ditë para zhvillimit të takimit të ndeshjes, shpenzimet e Super-kontrollit i bartë ekipi që ka kërkuar Super-kontrollin.
- 13.20.1. Nëse Super-kontrollin e kërkon ndonjë nga organet apo Komisionet e FHK-së, atëherë shpenzimet i bartë arka e FHK-së përkatësisht arka e SHGJHK-së kur këtë e kërkon SHGJHK-ja për nevojat e veta (kontrollimi i gjyqtarëve, kontrolluesve etj.).

- 13.20.2. Kërkesa për Super-kontroll me shkrim i dorëzohet Komisarit të garave, dhe atë e cakton Komisari i garave duke e njoftuar më parë kryetarin e Bordit të FHK-së për vendimin e marr.
- 13.20.3. Komisari i garave i cili udhëheq me gara, në zbatimin e procedurave ndëshkuese aplikon Aktet normative në fuqi.
- 13.21. Në ndeshjet me peshë të veçantë do të delegohen vëzhguesi dhe kontrolluesi për qëllim të mbikëqyrjes më të mirë të punës, dhe shpenzimet i bart Komisari i garave gjegjësisht FHK-ja.

XIV. Dënimet e klubeve

- 14.1. Paraqitja e klubit duhet të bëhet sipas 5.1, Çdo paraqitje me vonesë automatikisht tërheqë edhe gjobën prej 50 euro.
- 14.2. Skuadrat të cilave në fanella ju mungojnë numrat (para dhe mbrapa) dhe nuk i kanë fanellat, brekët dhe çorapet sportive të njëjta (ngjyra e njëjtë) dhe personat zyrtar të klubit nuk janë të veshur njësoj (laramani) neni 11.4, 11.5, 11.9 do të dënohen me gjobë 50 €. Skuadra i cili nuk e plotëson kushtin sipas 11.4, 11.5 dhe 11.9 dhe vëzhguesi –kontrolluesi nuk e ka kontrolluar sipas këtij neni dënohet me gjobë 50 €.
- 14.3. Skuadrat e Superligës së meshkujve të cilët nuk e kanë këtë kategori sipas 5.10. (juniorët) në gara do të dënohen me marrjen e 5 (pesë) pikëve nga fondi i fituar tek skuadra e seniorëve në Superligë për edicionin e ri garues 2026/27.
- 14.4. Skuadra e cila nuk paraqitet në gara me skuadrën e kadetëve (kadeteve) automatikisht përjashtohet nga garat edhe me ekipin e parë (seniorët).
- 14.5. Nëse gjatë zhvillimit të ndeshjeve të garave shtesë ndërpritet ndeshja për shkak të sulmit fizik ndaj personave zyrtar apo skuadrës kundërshtarë, apo ndonjë parregullsie tjetër dhe ndeshja regjistrohet me rezultat zyrtar, ekipi i ndëshkuar automatikisht shkualifikohet nga garat e mëtutjeshme, dhe dënohet me marrjen e 5 pikëve në edicionin 2026/27.
- 14.5.1. Në rast se skuadra e cila në garat shtesë nuk e zhvillon ndeshjen pa arsye (te cilin e vlerëson Komisari i garave), shkualifikohet nga garat dhe dënohet me marrjen 5 pikëve në edicionin 2026/27, dhe e humb të drejtën e pjesëmarrjes në garat e Kupave të EHF-it për edicionin 2026/27 dhe 2027/28.
- 14.6. Skuadra që gjatë një kampionati i humb dy ndeshje me rezultat zyrtar 0:10, automatikisht e humb statusin e anëtarit të ligës përkatëse, dhe nga sezoni i ardhshëm bën gara në një rang më të ulët të garave dhe do të sanksionohet me 500 € gjobë.
- 14.6.1. Në qoftë se ka zhvilluar më pak se 51 për qind të ndeshjeve, rezultatet e saja fshihen, kurse në qoftë se ka zhvilluar më tepër se 51 për qind, rezultatet e ndeshjeve të pazhvilluara regjistrohen me rezultat zyrtar 10:0 në të mirë të kundërshtarëve dhe do të sanksionohet me 500€ gjobë.
- 14.7. Skuadra vendëse do të dënohet në këto raste:
Për hedhjen e sendeve të forta dhe metalit në terren (shkrepës, monedha të metalta, kanaqe, etj.) skuadra do të gjobitet në shumën prej 100 €.
Nëse në terren disa herë bëhet hedhja e sendeve të forta dhe të metalit (shkrepës, monedha të metalta, kanaqe, etj.) atëherë skuadra do të gjobitet në shumën prej 200 €.
Për hedhje të lëndëve plasëse në terren (petardë etj.) me gjobë në shumën prej 300 €.
- Nëse vjen deri te ndërprerja e ndeshjes mbi 5 minuta për shkak të tymit (te lëndëve piroteknike) dhe arsyeve tjera skuadra organizatore do të dënohet me 500 €.

Konstatimi për publikun mysafir vlen vetëm atëherë kur skuadra mysafire i sjellë në mënyrë të organizuar tifozët e vetë me anë të shkresës zyrtare që ja dërgon skuadrës nikoqire si dhe vetë Komisarit të garave, apo kur identifikohet nga Policia e Kosovës individ apo grupi me shkresë zyrtare, si dhe në bazë të deklaratës së personave zyrtarë të ndeshjes.

14.8. Në rastet e përlëshjeve (rrahjes) së publikut me lojtarë (ose edhe persona zyrtarë) në fushë, si dhe shkaktimin e incidentit dhe ndërprerjes përkohësisht të ndeshjes skuadra vendase do të dënohet me gjobë nëse konstatohet se fajtor janë vendasit si vijon:

- 500 € gjobë për skuadrat e Superligës së meshkujve dhe 2(dy) ndeshje pa prezencën e publikut për skuadrat e Superligës së meshkujve.
- 300 € gjobë për skuadrat e Superligës së femrave dhe 2 (dy) ndeshje pa prezencën e publikut për skuadrat e Superligës së femrave.
- 200 € gjobë për skuadrat e Ligës së parë për meshkuj dhe femra dhe 2 (dy) ndeshje pa prezencën e publikut për skuadrat e Ligës së parë për meshkuj dhe femra.

Në rast se konstatohet se publiku i skuadrës mysafire ka shkaktuar përlëshjen apo incidentin, skuadra mysafire do të dënohet me 500 €.

Konstatimi për publikun mysafir vlen vetëm atëherë kur skuadra mysafire i sjellë në mënyrë të organizuar tifozët e vetë me anë të shkresës zyrtare që ja dërgon skuadrës nikoqire si dhe vetë Komisarit të garave, apo kur identifikohet nga Policia e Kosovës individ apo grupi me shkresë zyrtare, si dhe në bazë të deklaratës së personave zyrtarë të ndeshjes.

14.9. Në rastet e përlëshjeve (rrahjes) së publikut me lojtarë (ose edhe persona zyrtarë) në fushë, si dhe shkaktimin e incidentit dhe ndërprerjes deri në fund skuadra vendase do të dënohet nëse konstatohet se fajtor janë fajtor janë vendasit si vijon: .

- 500 € gjobë dhe 3-5 ndeshje të zhvillimit të ndeshjeve 30 km si vendas për skuadrat e Superligës së meshkujve.
- 300 € gjobë dhe 3-5 ndeshje të zhvillimit të ndeshjeve 30 km si vendas për skuadrat e Superligës së femrave
- 200 € gjobë dhe 3-5 ndeshje të zhvillimit të ndeshjeve 30 km si vendas për skuadrat e
- Në rast se konstatohet se publiku i skuadrës mysafire ka shkaktuar përlëshjen apo incidentin, skuadra mysafire do të dënohet me 700 €.

Konstatimi për publikun mysafir vlen vetëm atëherë kur skuadra mysafire i sjellë në mënyrë të organizuar tifozët e vetë me anë të shkresës zyrtare që ja dërgon skuadrës nikoqire si dhe vetë Komisarit të garave, apo kur identifikohet nga Policia e Kosovës individ apo grupi me shkresë zyrtare, si dhe në bazë të deklaratës së personave zyrtarë të ndeshjes.

14.10. Skuadra vendëse është e obliguar të sigurojë së paku tre kronometra për matjen e kohës, dy topa për zhvillimin e ndeshjes, pipin rezervë, ekzemplarë të nevojshëm të procesverbalit si dhe kushtet normale për përpilimin e tij. Po ashtu është i obliguar t'i japë ndihmë vëzhguesit me rastin e përpilimit të procesverbalit dhe eventualisht me rastin e marrjes në pyetje të personit të caktuar (marrja e deklaratave me shkrim etj.).

14.10.1. Në rastet kur në ndeshje mungon vëzhgues – kontrolluesi apo semafori nuk punon ose është prishje, atëherë përfaqësuesit zyrtarë të dy ekipeve kanë të drejtë të qëndrojnë në tavolinën zyrtare.

14.11. Nëse njëra nga skuadrat nuk ka dëshmi (fletëpagesë të pagesës së pjesëmarrjes), ndeshja nuk do të zhvillohet dhe ajo do të regjistrohet me rezultat 10:0 në të mirë të kundërshtarit. Nëse dy skuadrat nuk e argumentojnë pagesën e pjesëmarrjes, ndeshja nuk mund të zhvillohet, ndërsa ekipet fitojnë 0 pikë dhe evidencohen si ndeshje të pazhvilluara, dhe nëse edhe një ndeshje nuk e zhvillojnë gjatë

Kampionatit, e humbin statusin e anëtarit të ligës përkatëse. I njëjti rast vlen kur kemi edhe me mos përmbushjen e obligimeve të skuadrave ndaj FHK-së sipas urdhëresë së publikuar ne Buletinin e radhës.

- 14.12.** Nëse në ndeshjen e ardhshme të Kampionatit ose për Kupë aktivizohet lojtari i suspenduar ose personi përkatës zyrtar, ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar 10:0 për ekipin kundërshtar dhe ekipi do të dënohet me 200 € gjobë.
- 14.13.** Skuadrat pjesëmarrëse në gara paraqiten me ngjyrat e skuadrës, secila skuadër duhet të ketë të paraqitur dy lloje të fanellave ngjyrën e qelët dhe të mbyllt. Nëse të dy skuadrat kanë ngjyrë primare të njëjtë, skuadra mysafire është i obliguar të sigurojë ngjyrë tjetër të fanellave ngjyrën sekondare, kjo procedurë duhet të përmbushet gjatë takimit teknik një orë para fillimit të ndeshjes. Të gjitha ekipet janë të obliguara t'i paraqesin ngjyrat e fanellave me të cilat do të zhvillojnë ndeshjet gjatë kampionatit. Skuadrat që nuk i paraqesin para fillimit të Kampionatit ngjyrat e fanellave të klubeve do të dënohen me nga:
- 200 € skuadrat e Superligës së meshkujve.
 - 150 € skuadrat e Superligës së femrave.
 - 100 € skuadrat e Ligës së parë (meshkuj dhe femra).
- P.s: Skuadra vendas në çdo rast ka përparësi të zgjedhjes së ngjyrës primare në cilësinë e vendasit, të lajmëruar sipas Buletinit.
- 14.14.** Nëse nuk përmbushen kushtet paraprake sipas 8.8. deri 8.8.4. mbi organizmin e ndeshjes, atëherë vlerësohet si organizim i dobët i ndeshjes, për çka ekipi do të dënohet në shumën prej:
- 200 € për skuadrat e Superligës (femra dhe meshkuj)
 - 150 € për skuadrat e Ligës së parë (femra dhe meshkuj)
 - 100 € për skuadrat e Ligës së dytë dhe Ligave tjera.
- 14.15.** Nëse nuk veprohet sipas vendimit të Komisarit të garave sipas paragrafit 8.9 dhe 8.9.1 të publikuar në Buletinin e radhës skuadra organizatore do të gjobitet në shumë prej:
- Superliga – meshkujt 200 €
 - Superliga - femrat 150 €
 - Liga e parë – meshkujt dhe femrat 100 €

XV. Dënimet e lojtarëve, personave zyrtar, trajnerëve, gjyqtarëve dhe vëzhguesve-kontrolluesve

- 15.1.** Lojtarët dhe personat zyrtarë (këtu bëjnë pjesë trajneri, udhëheqësi teknik, përfaqësuesi zyrtar i ekipit dhe mjeku) të shkualifikuar me Raport (kartonin e kaltër) automatikisht suspendohen dhe nuk kanë të drejtë të ushtrojnë funksionin, përkatësisht të drejtë loje deri në marrjen e vendimit nga ana e Komisarit të garave (Formulari nr.19).
- 15.2.** Nëse mungon dikush apo takimi teknik sipas 8.1, 8.1.1 vonohet për arsye të mungesës së gjyqtarëve, vëzhguesit-kontrolluesit nuk janë prezent në takim teknik do të ndëshkohet me gjobitje sipas nenit 8.1.5
- 15.3.** Lojtari, trajneri apo personi zyrtarë i shkualifikuar për shkak të sjelljeve jospportive ndaj personave zyrtarë, lojtarëve kundërshtarë apo edhe bashkë lojtarëve (kur kemi të bëjmë me kartonin e kaltër) do të dënohet me 2- 6 ndeshje mos lojë dhe mjete materiale prej:
- 200 € gjobë për lojtarët e Superligës së meshkujve
 - 150 € gjobë për lojtaret e Superligës së femrave

- 100 € gjobë për lojtarët e Ligës së parë të meshkujve dhe femrave

15.3.1. Trajneri apo personi zyrtarë i skuadrës i cili shkualifikohet për sjellje josportive ndaj personave zyrtarë apo skuadrës kundërshtare (lojtarëve, trajnerëve etj.) dënohet me gjobë prej:

- 200 € gjobë për trajnerët e Superligës së meshkujve.
- 150 € gjobë për trajnerët e Superligës së femrave.
- 100 € gjobë për trajnerët Ligës së parë meshkujt dhe femrave.

15.3.2. Trajneri apo personi zyrtarë i skuadrës i cili ndëshkohet me 2 minuta gjatë ndeshjes për sjellje josportive ndaj personave zyrtarë apo skuadrës kundërshtare (lojtarëve, trajnerëve etj.) dënohet me gjobë prej:

- 50 € gjobë për trajnerët e Superligës së meshkujve.
- 50 € gjobë për trajnerët e Superligës së femrave
- 50 € gjobë për trajnerët e Ligës së parë meshkujt dhe femrave.

Në rastet e përsëritura dënimet do të jenë progresive.

Skuadra e cili nuk e përmbush obligimin e gjobës së dënimit, mund të zhvillon ndeshjen e radhës por nuk guxon të aktivizohet lojtari, trajneri apo personi zyrtarë i ndëshkuar – dënuar deri në përmbushjen e obligimit.

15.4. Lojtari, trajneri apo presoni zyrtarë i shkualifikuar me Raport (karton të kaltër) për shkak të tentimit apo sulmit fizikë ndaj personave zyrtarë, lojtarëve kundërshtarë apo edhe bashkë lojtarëve do të dënohet me 4 ndeshje deri në 2(dy) vjet mos lojë dhe me gjobitje me mjete materiale në shumë prej si vijon:

- 300 € gjobë për lojtarët e Superligës së meshkujve
- 150 € gjobë për lojtarët e Superligës së femrave
- 100 € gjobë për lojtarët e Ligës së parë të meshkujve dhe femrave

Në rastet e përsëritura dënimet do të jenë progresive.

Skuadra e cili nuk e përmbush obligimin e gjobës së dënimit, mund të zhvillon ndeshjen e radhës por nuk guxon të aktivizohet lojtari, trajneri apo personi zyrtarë i ndëshkuar – dënuar deri në përmbushjen e obligimit.

15.5. Lojtari i shkualifikuar për faull të rëndë (ashpër) gjatë duelit me lojtarin kundërshtarë dhe sjellje josportive dhe merr kartonin e kuqë pa Raport, automatikisht do të dënohet me gjobitje si vijon:

- 100 € gjobë për lojtarët e Superligës së meshkujve
- 50 € gjobë për lojtarët e Superligës së femrave
- 50 € gjobë për lojtarët e Ligës së parë të meshkujve dhe femrave

15.5.1. Lojtari i shkualifikuar për faull të rëndë (ashpër) me qëllim, ndërprerjes së aksionit në 30 sekondat e fundit, zhegitja e lojës apo sjellje tjera sipas rregullës 8:5 dhe 8:6 i cili ndëshkohet me karton të kuqë dhe karton të kaltër automatikisht do të dënohet me 1 ndeshje mos lojë dhe një gjobitje si vijon:

- 100 € gjobë për lojtarët e Superligës së meshkujve
- 50 € gjobë për lojtarët e Superligës së femrave
- 50 € gjobë për lojtarët e Ligës së parë të meshkujve dhe femrave

15.5.2. Portieri i cili shkualifikohet pa raport gjatë intervenimit jashtë zonës së vetë (6 m) për kontakt me lojtarin kundërshtarë nuk do të dënohet me asnjë ndeshje mos lojë por vetëm me- 100 euro gjobitje Superliga e meshkujve , 50 euro gjobë Superliga e femrave, 50 euro Liga e parë meshkujt dhe femrat (nëse kjo nuk ka ndodh në 30 sekondat e fundit, në rastet kur ndodh aplikohet paragrafi më lartë) dhe ka të drejt aktivizimi në xhiron e radhës.

Lojtari, trajneri apo personi zyrtarë i cili nuk e përmbush obligimin e gjobës së dënimit, nuk mund të zhvillon ndeshjen e radhës dhe nuk guxon të aktivizohet në lojë deri në përmbushjen e obligimit.

- 15.6.** Nëse ndonjë nga personat zyrtarë nuk e nënshkruan procesverbalin e ndeshjes, në bazë të paraqitjes së vëzhguesit do të dënohet prej 3 muaj deri në një vit ndalesë të ushtrimit të çfarë do funksioni në hendboll.
Për zhdukjen e procesverbalit nga çdo person në palestër ose fushë apo në lokalet e ekipit, ekipi do të dënohet me të holla në shumën prej 200 €, sipas paraqitjes së vëzhguesit të ndeshjes.
- 15.7.** Vëzhgues-kontrolluesi i cili nuk i përmbahet plotësisht të kushtit sipas 11.4, 5.8.1, 11.9 dhe 9.2 dhe këtë nuk e konstaton në procesverbal të ndeshjes dënohet me gjobë prej 50 €.
- 15.7.1. Nëse në ndeshje paraqitet laramani sipas 13.2.4 të theksuar dhe vëzhguesi/kontrolluesi nuk i ka paraqitur në procesverbal do të ndëshkohet me 100 euro.
- 15.8.** Nëse vëzhguesi apo vëzhgues-kontrolluesi nuk e sjell procesverbalin në afat prej 48 orëve pas përfundimit të ndeshjes në zyrën e FHK-së, apo para KG-së do të ndëshkohet me mos delegim prej 1 deri në 2 ndeshje të Kampionatit apo për Kupë, si dhe do të gjobitet me 100 €.
- 15.8.1. Nëse vëzhgues-kontrolluesi e dërgon me post procesverbalin, duhet që paraprakisht të e dërgon në formë elektronike, në mënyrë që Komisari i garave të mund të mbaj mbledhjen e radhës dhe të bëjë regjistrimin e ndeshjes, kush nuk i përmbahet këtij neni do të ndëshkohet me mos delegim prej 1 deri në 2 ndeshje të Kampionatit apo për Kupë, si dhe do të gjobitet me 100 €.
- 15.9.** Nëse procesverbali nuk i përmban të gjitha shënimet e kërkuara, si shënimet për përfaqësuesit zyrtarë, lojtarëve, numri i golave të shënuara dhe deklaratat në të, vëzhgues-kontrolluesi do të ndëshkohet me 50 € nëse konstatohet se ka shkruar në Raportin mbi vëzhgimin e ndeshjes se puna e procesmbajtësit dhe kohëmatësit ka qenë korrekte.
- 15.9.1. Nëse në procesverbal (nënkuptohet nëse ka raste kontestuese apo raste për Raport të gjere) e plotëson ndonjë rast kontestues, vëzhgues-kontrolluesi është i obliguar që ti shkruar fletëparaqitje dhe jo vetëm në procesverbal të shënohet, në të cilën duhet të përshkruhen të gjitha ngjarjet të një ndeshjeje sidomos momentet kontestuese të paraqitura dhe të përshkruara nga përfaqësuesit zyrtarë të skuadrave apo gjyqtarët dhe personat tjerë të ndeshjes dhe nga një ekzemplar në mënyrë obliguese ti dorëzon përfaqësuesve të dy skuadrave, vëzhgues-kontrolluesi i ndeshjes do të dënohet prej 200 gjobitje.
- 15.10.** Lojtarët, trajnerët, personat zyrtarë të skuadrave të cilët haptazi në medime, portale, rrjete sociale kritikojnë referimin pa argumente dhe nëse Komisari i garave konstaton se nuk kanë pasur të drejtë do të dënohen me të holla në shumë prej:
- 100 € gjobë për lojtarët, personi zyrtar në Superligës së meshkujve dhe femrave.
 - 50 € gjobë për lojtarët, personi zyrtar në Ligës së parë të meshkujve dhe femrave
 - 50 € gjobë për lojtarët, personi zyrtar në Ligës së grup-moshave të reja.
- 15.11.** Gjyqtarët të cilët vlerësohen me nota jo të kënaqshme nga kontrolluesi i ndeshjes (apo Komisioni profesional i SHGJHK-së) sipas Raportit mbi kontrollin e referimit, do të dënohen sipas këtyre kritereve të parapara nga Komisari i garave:
- vlerësimi me 36 – 50 pikë 2 ndeshje ndalesë dhe 100 euro
 - vlerësimi me 21 – 35 pikë 4 ndeshje ndalesë dhe 200 euro
 - vlerësimi me 0 - 20 pikë 8 ndeshje dhe 500 euro dhe largimi nga Lista për edicionin aktual të garave.

Vlerësimin e bënë Vlerësuesi i profesional i SHGJHK-së (i cili sipas vendimit të KD të SHGJHK-së e zëvendëson Komisionin profesional të SHGJHK-së) në bazë të Raportit mbi vlerësimin e gjyqtarëve dhe video xhirimeve të ndeshjeve, dhe vlerësimi publikohet në Buletinin e radhës.

Vendimin mbi dënimin e gjyqtarëve dhe vëzhgues-kontrolluesve e merr organi përkatës gjegjësisht Komisarit i garave në shkallën e parë sipas Raportit të Këshillit profesional të SHGJHK-së kur kemi të bëjmë me rastet diskutabile, kurse gjyqtari mund t`i drejtohet në afat prej 8-të dite organit në shkallën e dytë nga marrja e vendimit të shkallës së parë. Ankesa duhet të shkojë për mes formës së shkruar dhe ti drejtohet organit i cili e ka shqiptuar dënimin, duke bërë pagesën e taksës në shumë prej 50 €.

Dënimet e shqiptuara ju llogariten në delegimin gjatë edicionit 2025/26.

15.12. Komisarit i garave në shkallë të parë do të merr masa ndëshkuese ndaj vëzhgues-kontrolluesve të cilët nuk ju përmbahen kriterëve si vijon:

- 15.12.1. Për mos plotësim (shënim) të vërejtjeve (pozitive, negative dhe sugjerime) në anën e përparme të formularit të kontrollit me përshkrim të komponentit
- 15.12.2. Për çdo ditë të vonësës së kontrollit, në të gjitha këto raste masa ndëshkuese ndaj vëzhgues-kontrolluesve do të ju shqiptohet nga një ndeshje mos delegim.
- 15.12.3. Në përfundim të çdo muaji, gjysmë sezonit dhe në përfundim të Kampionatit do të mblidhen pikët e përgjithshme ndëshkuese, dhe do të bëhet shkallëzimi i kontrolluesve sipas punës dhe suksesit të treguar.
- 15.12.4. Masat ndëshkuese për shkak të mos aplikimit të vlerësimit të notimit adekuat nga rregullat e lojës. Me rastin e shikimit të video xhirit të ndeshjes (nëse skuadra kërkon me shkrim dhe bënë pagesën në shumë prej 50 €) apo Raportit të Vlerësuesit të gjyqimit të konstatohet se kontrolluesi në numrin e përgjithshëm të pikëve ka dëmtuar apo shpërblyer gjyqtarët për numrin e përgjithshëm të pikëve, ndëshkohet (sanksionohet) kontrolluesi si vijon:
 - deri në 5 pikë diferencë i shqiptohet masa vërejte
 - deri në 10 pikë diferencë i shqiptohet dënimi me 1 ndeshje
 - deri në 15 pikë diferencë i shqiptohet dënimi me 2 ndeshje
 - deri në 20 pikë diferencë i shqiptohet dënimi me 4 ndeshje

Kundër vendimit të Komisarit të garave i cili vendos si organ i shkallës së parë, ekipi, respektivisht, lojtarët, gjyqtarët, vëzhgues-kontrolluesi dhe personat e tjerë zyrtarë të pakënaqur më vendimin e organit të shkallës së parë (KG-së) kanë të drejtë ankese organit të shkallës së dytë të FHK-së, dhe në këtë rast organi i Shkallës së dytë do të përbehet nga kryetari i Këshillit të garave dhe dy anëtarë të cilët i cakton KD i SHGJHK-së si trup profesionale nga radhët e saj. Në këto raste dy anëtarët e caktuar nuk mundin me qenë anëtarë të Këshillit të garave në ndeshjet ku kanë qenë pjesëmarrës

15.13. Për moszbatim të detyrave dhe obligimeve që dalin nga urdhëresat e Komisarit të garave në Buletinet zyrtare të FHK-së, mos zbatuesit do të dënohen me gjobë prej 100 €.

15.14. Personi i cili e tërheq skuadrën gjatë zhvillimit të ndeshjes automatikisht i nënshtrohet suspendimit dhe ai dënohet me lojë, përkatësisht me mos ushtrim të detyrave të tjera në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj deri në 1 (një) vit. Skuadra e cili në kohën e paraparë nuk kthehet për të vazhduar ndeshjen do të dënohet në shumën prej 200 €, ndërsa personi përgjegjës dënohet me ndalimin e ushtrimit të detyrës prej tre deri në 2 muaj dhe me gjobë prej 200 €.

15.15. Çdo sulm dhe fyerje ndaj tyre (gazetarë, kameraman etj.) nga ana e lojtarëve, gjyqtarëve, trajnerëve dhe personave të tjerë zyrtarë të ndeshjes do të sanksionohet sipas akteve normative të FHK-së qoftë në media elektronike apo të shkruara si dhe rrjetet sociale.

- 15.16.** Personat zyrtarë (gjyqtarët dhe vëzhgues-kontrolluesit) nëse i komentojnë në një a tjetër mënyrë postimet e të tjerëve në rrjetet sociale do të gjobiten nga 200 euro.
- 15.17.** Prandaj kush poston, shpërndan ose pëlqeni ndonjë përmbajtje që mund të konsiderohet abuzive ose kërcënuese ose e turpshme dhe sidomos nëse thuhet gjëra negative për të tjerët në postimet e mediave dhe rrjetet tuaja sociale do të sanksionohen me 200 euro. Kjo vlen edhe për nenin 15.16.

XVI. Organizimi i reklamave në palestër

- 16.1.** Klubet janë të obliguara që të sigurojnë hapësirë në pjesën qendrore të fushës për ti vendosur 2 (dy) pano me dimensione 2 x 1 m te cilat i siguron FHK-ja, në çdo ndeshje të Kampionatit apo Kupës së Republikës së Kosovës. Si e drejtë ekskluzive e reklamës së FHK-së apo sponsorit të FHK-së. Në rastet e sigurimit të sponzorit të Superligës klubet janë të obliguar ti përmbahen marrëveshjes së nënshkruar nga FHK-ja.
- 16.2.** Klubet e Superligës së meshkujve dhe femrave kanë mundësinë të përdorin reklama statike po ashtu edhe sistem LED të reklamave gjatë zhvillimit të ndeshjes Kampionale,
- 16.3.** Në kuadër të ndeshjeve të rregullta klubet kanë të drejtë të përdorimit të reklamave statike në gjatësi 2- 1 m, në gjatësi totale prej 40 -42 metra
- 16.4.** Është e ndaluar në gjatësi prej 40 metra përgjatë fushe përdorimi i njëres pjesë reklama statike dhe anën tjetër LED sistem, kombinimet të tilla lejohet vetëm në ras për gjatë 40 metrave përdorimi i sistemit LED kurse në dy anët 20 m, prapa gole të vendoset reklama statike.
- 16.5.** Në rast të përdorimit të reklamave LED, klubi nikoqir është i obliguar që të dërgoj dimensionet e LED dhe të siguroj hapësirë reklamues për FHK-në deri 5 minuta për gjatë zhvillimit të ndeshjes zyrtare në kuadër të Superligës së meshkujve dhe femrave, po ashtu në kuadër të Kupës së Kosovës.
- 16.6.** Në rast të përdorimit të reklamave statike, klubi nikoqir është i obliguar që të siguroj reklama statike me llogon e FHK dhe Ligës në të cilën garon.
- 16.7.** Ndeshjet gjysmëfinale dhe finale të play offit, FINAL4 i Kupës së Kosovës dhe ndeshjet finale të Superkupës së Kosovës duhet të luhen vetëm me vija hendbolli. Klubet janë përgjegjëse për të dërguar, ngritur, hequr dhe ruajtur gerflorin, si dhe materialet përkatëse.
- 16.8.** Në kuadër të ndeshjeve gjysmëfinale dhe finale kur kemi të bëjmë me transmetime televizive klubet janë të obliguar të bëjnë instalimin e sistemit LED për gjatë 40 metrave të gjatësisë së fushës.

XVII. Afatet ligjore

- 17.1.** Anëtarët e Bordit të FHK-së janë të obliguar që nëse janë prezent në ndeshje të raportojnë me shkrim lidhur me situatën e krijuar sidomos ekscese, me çka do të ndihmohet puna e Komisarit të garave dhe mbarëvajtjes së garave.
- 17.2.** Vendimin për masat disiplinore ndaj lojtarëve, gjyqtarëve, vëzhguesit, kontrolluesit, procesmbajtësit, matësit të kohës, trajnerit, përfaqësuesve të ekipeve etj. në rangun e shkallës së parë e merr Komisarit i garave në mbështetje të Rregullores disiplinore të FHK-së dhe dispozitave të këtyre propozicioneve.

17.3. Në ndeshjen e zhvilluar skuadra ka të drejtë ankese e cila paraqitet ekskluzivisht përmes përfaqësuesit të autorizuar të klubit të shënuar në procesverbal të ndeshjes. Paraqitja e ankesës bëhet pas përfundimit të ndeshjes dhe atë në afatin, më së largu 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes në formularin e posaçëm (Formulari nr. 20) dhe të bëhet pagesa në shumë 100€ te vëzhgues apo përmes bankës, nëse është ditë pushimi, parashtuesi i ankesës është i obliguar që të bëjë pagesën në ditën e parë të punës. Me këtë rast nuk është e obliguar të jepet arsyetimi i paraqitjes së ankesës në formularin e posaçëm i cili gjendet tek vëzhgues-kontrolluesi, ndërkaq gjyqtarët dhe vëzhguesi duhet të japin mendimin e tyre lidhur me ankesën e paraqitur.

17.4. Ankesa në regjistrimin e lojtarëve dhe të drejtën e tyre për lojë duhet të paraqitet para fillimit të ndeshjes në procesverbal dhe në formularin e posaçëm (Formulari nr. 20) i cili gjendet tek vëzhgues-kontrolluesi nga përfaqësuesi zyrtarë (me nënshkrim), në të kundërtën ajo nuk do të merret në shqyrtim.

13.4.1 Arsyetimi me shkrim të ankesës të paraqitur nga klubi dorëzohet me së voni 48 orë pas përfundimit të ndeshjes si dhe pagesa e shumës së 100 € për Superligën e meshkujve, 100 € për Superligën e femrave dhe nga 50 € për Ligat e tjera.

13.4.2 Vula e postës merret si argument i dorëzimit në afatin e paraparë të ankesës apo postës elektronike nga e-maili zyrtar i ekipit i paraqitur para fillimit të garave si adresë zyrtare e klubit. Arsyetimi me shkrim ndaj ankesës së paraqitur pas afatit të paraparë nuk do të merret në shqyrtim, përkatësisht do të vlerësohet si e paraqitur pas afatit të paraparë.

17.5. Përveç çdo paraqitjeje të ankesës brenda 48 orëve ekipi është i obliguar të bëjë pagesën e taksës në shumën prej 100 € te Superliga e meshkujve, 100 € për Superligën e femrave dhe nga 50 € për Ligat e tjera, në të kundërtën ankesa nuk do të merret në shqyrtim, dhe do të konstatohet se ekipi ka hequr dorë nga ankesa.

Për shumën e dorëzuar e të hollave vëzhguesi (apo zyra e FHK-së) lëshon dëshmi e pagesës ose evidenton atë në raportin e vëzhgimit të cilin formular ju dorëzon te dy skuadrave nga një kopje dhe një kopje e sjell në zyret e FHK-së, përkatësisht fletëpagesën si dëshmi se është paguar taksa e paraparë për ankesën e paraqitur. Taksën e paguar vëzhguesi është i obliguar ta dorëzojë në arkën apo llogarinë rrjedhëse të FHK-së.

17.6. Kundër vendimit të Komisarit të garave i cili vendos si organ i shkallës së parë, ekipi, respektivisht, lojtarët, gjyqtarët, vëzhgues-kontrolluesi dhe personat e tjerë zyrtarë të pakënaqur më vendimin e organit të shkallës së parë (KG-së) kanë të drejtë ankese organit të shkallës së dytë, Këshillit të garave.

Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, organit të shkallës së dytë që i paraqitet në afatin prej 8 ditësh nga dita e marrjes së Buletinit të radhës, në të cilin edhe publikohet Vendimi i Komisarit të garave si organ i shkallës së parë, pas pagesës së taksës prej:

- 100 € për ekupe
- 50 € për persona zyrtarë (gjyqtarë dhe kontrollues-vëzhgues)

Nga pjesa e taksës në shumë prej 100 € gjegjësisht 50 € është i liruar ekipi apo individ i cili të njëjtën e ka paguar me rastin e paraqitjes së ankesës para organit të shkallës së parë (Komisarit të garave).

Sipas ankesës Këshilli i garave vendos në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së ankesës.

Vendimi i Këshillit të garave është i formës së prerë dhe definitiv në procedurën administrative.

Kundër Vendimit të Këshillit të garave pala e pakënaqur mund të ushtrojë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm ligjor, në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit të

organit të shkallës së dytë dhe ai i dorëzohet Bordit të FHK-së.

- 17.7.** Ankesa në ndeshjet e garave shtesë (Play-off dhe Play-out, pjesës finale të Kupës së Republikës) i dorëzohet Komisarit të garave në afat prej gjashtë (6) orëve pas përfundimit të ndeshjes, duke bërë pagesën në shumës së 100 €.

Vendimi mbi ankesën në shkallën e parë merret në afat prej dymbëdhjetë (12) orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim.

Në këtë vendim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë – Këshillin të garave në afat prej dymbëdhjetë (12) orëve, i cili vendim do të merret në afat prej dymbëdhjetë orëve (12) orëve.

- 17.8.** Të gjitha ndeshjet e zhvilluara Komisari i garave i regjistron në afatin prej 48 orëve e më së voni para fillimit të ndeshjeve të javës në vijim, nga dita e zhvillimit të tyre në bazë të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni zyrtar (procesverbali i ndeshjes, raportet e gjyqtarëve dhe vëzhguesit etj), përveç ndeshjeve të Play-off dhe Play-out, pjesës finale të Kupës së Republikës të cilat regjistrohen menjëherë pas përfundimit të tyre.

Në rast të paraqitjes së ankesës në ndeshje afati i regjistrimit të ndeshjes shtyhet deri në 7 ditë. Në rastet e jashtëzakonshme kur duhet të mbledhen materialet argumentuese për ndeshjen e ndërprerë ajo mund të shtyhet për regjistrim më së largu 15 ditë.

XVIII. Përmbyllja

- 18.1.** Interpretimin e këtyre Propozicioneve e bënë Bordi i FHK-së.
- 18.2.** Ndryshimet dhe plotësimet e këtyre Propozicioneve të garave të bëhen në të njëjtën mënyrë sikur se edhe janë miratuar.
- 18.3.** Në rastet e jashtëzakonshme këto Propozicione mund të ndryshohen nga Bordi i FHK-së dhe të përshtaten me gjendjen faktike sipas rastit si në rast të shfaqjes së ndonjë gjendje të jashtëzakonshme.
- 18.4.** Këto Propozicione hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Bordi dhe aplikohen për vitin garues 2025/26.

BORDI I FHK-së
Edin KOLGECI d.v.
President